<p>nga anëtarët e mbetur të Këshillit drejtues, për një periudhë jo më shumë se gjashtë (6) muaj. Në të dy rastet, sapo të kompletohet Këshilli drejtues, do të organizohen zgjedhjet e reja për kryesuesin dhe zëvendëskryesuesin.</p> <p>10. Të gjithë anëtarët e Këshillit drejtues shërbejnë me kohë të pjesshme dhe takohen një herë në dy (2) muaj, me përjashtim të rasteve të jashtëzakonshme.</p> <p>11. Mandati i anëtarit të Këshillit drejtues përfundon para kohe me rastin e vdekjes, dorëheqjes ose shkarkimit.</p> <p>12. Anëtari i Këshillit drejtues mund të shkarkohet nga organi që e ka emëruar apo zgjedhur vetëm për këto arsye bindëse si:</p> <p>12.1. Dënim për një vepër penale që është i formës së prerë;</p> <p>12.2. Paaftësi në kryerjen e funksioneve të postit për shkak të paaftësisë fizike apo mendore në kohëzgjatje prej 6 muaj, të dokumentuar me një raport nga komisioni mjekësor, të caktuar sipas legjislacionit në fuqi;</p> <p>12.3. Dështim, refuzim, shpërfillje,</p>	<p>remaining members of the board, for a period of not more than six (6) months. In both cases, once the board is completed, new elections will be organised for the Chairman and Vice-Chairman.</p> <p>10. All Steering Council members serve part-time and meet about once in two (2) months, except in emergency cases.</p> <p>11. The member's mandate of the Steering Council ends before time in case of death, resignation or discharge.</p> <p>12. The member of the Steering Council can be discharged by the body that has nominated or elected it for only these convincing reasons, such as:</p> <p>12.1. Punishment for a criminal offense, which is of final form;</p> <p>12.2. Inability to perform postal duties due to physical or mental disability for a period of 6 months, documented with a report by the medical commission, determined according to the legislation in force;</p> <p>12.3. Failure, rejection, disregard,</p>	<p>članova Upravnog odbora, za period ne duži od šest (6) meseci. U oba slučaja, odmah nakon sastavljanje Upravni odbor, biće organizovani novi izbori za predsednika i potpredsednika.</p> <p>10. Svi članovi Upravnog odbora služe skraćeno radno vreme i sastaju se jednom u dva (2) meseca, osim u hitnim slučajevima.</p> <p>11. Mandat članova Upravnog odbora se završava pre vremena u slučaju smrti, ostavke ili njegovim razređenjem.</p> <p>12. Član Upravnog odbora može biti razrešen od strane organa koji ga je imenovao ili izabrao samo iz sledeće ubedljive razloge, kao što su:</p> <p>12.1. Kazna za krivično delo koja je pravosnažna;</p> <p>12.2. Nesposobnost u obavljanju funkcija nakon fizičke ili mentalne nesposobnosti, u periodu od 6 meseci, dokazano izveštajem lekarske komisije u skladu sa važećim zakonima;</p> <p>12.3. Neuspeh, odbijanje, ne obaziranje,</p>
---	---	--

<p>paaftësi të vazhdueshme për të përmbushur detyrat e postit, ose për të vepruar në përputhje me parimet e përcaktuara në statutin e institucionit apo në këtë ligj.</p> <p>13. Nismën për shkarkimin e anëtarit të Këshillit drejtues mund ta jep vet Këshilli drejtues me 2/3 e numrit të përgjithshëm të votave të anëtarëve të Senatit të institucionit.</p> <p>14. Në rast të një nisme të tillë, organi që e ka zgjedhur ose emëruar anëtarin për të cilin propozohet shkarkimi, është i detyruar t'a shqyrtojë propozimin në afat prej 30 ditësh.</p> <p>15. Shkarkimi i anëtarëve të Këshillit drejtues që vijnë nga senati, mund të bëhet me 2/3 të votave të senatit, ndërsa shkarkimin e anëtarëve që vijnë nga Ministria e bën ministri.</p> <p>16. Në rast të përfundimit të parakohshëm të mandatit të anëtarit të Këshillit drejtues, anëtari i ri zgjidhet apo emërohet për të zëvendësuar anëtarin që largohet, në përputhje me procedurën e përshkruar në këtë nen, për periudhën e mbetur kohore të mandatit të anëtarit që e ka përfunduar mandatin para kohe.</p>	<p>continuous disability to fulfil the duties of the position or to act in accordance with the principles set out in the statute of the institution or in this Law.</p> <p>13. The initiative for discharge of the Steering Council member can be given by the Steering Council itself with 2/3 of the overall number of votes of the institution's Senate members.</p> <p>14. In case of such an initiative, the body that elected or appointed member for whom discharge is proposed, is obliged to review the proposal within 30 days.</p> <p>15. The dismissal of the members of the Steering Council coming from the Senate can be done with 2/3 of the Senate vote, while the dismissal of the members from the ministry is made by the minister.</p> <p>16. In the event of early termination of the mandate of a member of the Steering Council, a new member is elected or appointed to replace the departing member, in accordance with the procedure described in this article, for the remaining period of the mandate of the member who has not completed its mandate.</p>	<p>kontinuirana nemogućnost da se ispune obaveze te pozicije ili da se postupi u skladu sa principima utvrđenim statutom institucije ili u ovom Zakonu.</p> <p>13. Inicijativa za razrešavanje člana Upravnog odbora može dati sam Upravni odbor sa 2/3 od opšteg broja glasova, Senata institucije.</p> <p>14. U slučaju ovakve inicijative, telo koje bira, odnosno imenuje člana za kojeg je predloženo otpuštanje, dužno je da razmotri predlog u roku od 30 dana.</p> <p>15. Razrešenje članova Upravnog odbora koje nastaje od strane senata vrši se 2/3 glasanjem senata, međutim razrešenje članova čini ministarstvo a to čini ministar.</p> <p>16. U slučaju prevremenog ranog prestanka mandata člana Upravnog odbora, novi član se bira ili imenuje kao zamena za člana koji odlazi, u skladu sa procedurom koja je opisana u ovom članu, za preostali period mandata člana koji nije završio svoj mandat.</p>
---	---	--

<p style="text-align: center;"><b>Neni 23 Senati</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 23 The Senate</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 23 Senat</b></p>
<p>1. Senati është organi kryesor akademik i institucionit publik të arsimit të lartë. Senati mban përgjegjësinë kryesore për vendimmarrjen në çështjet akademike.</p> <p>2. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të Senatit janë:</p> <p>2.1. Të mbroj autonominë e institucionit të arsimit të lartë, lirinë akademike, si dhe të drejtat e studentëve;</p> <p>2.2. Aprovon statutin e institucionit të arsimit të lartë para se të miratohet nga Këshilli drejtues;</p> <p>2.3. Të zgjedhë anëtarët e Këshillit drejtues që propozohen nga institucioni;</p> <p>2.4. Të shpallë konkursin për rektor, pranojë aplikacionet dhe krijojë për Këshillin drejtues listën e renditur të dy (2) deri në tre (3) kandidatëve për përzgjedhjen e rektorit të atij institucioni;</p> <p>2.5. Të zgjedhë, rizgjedhë dhe avancojë në thirrje akademike personelin</p>	<p>1. The Senate is the main collegial academic body of a public higher education institution. The Senate holds the primary responsibility for decision-making on academic matter.</p> <p>2. Main duties and responsibilities of the Senate are:</p> <p>2.1. To guarantee the autonomy of the higher education institution, academic freedom, as well as the rights of students;</p> <p>2.2. To approve the statute of the higher education institution prior to its adoption by the Steering Council;</p> <p>2.3. To select the Steering Council members who are proposed by the institution;</p> <p>2.4. To announce the competition for Rector, accepts applications and establish for the Steering Council a list ranked of two (2) to three (3) candidates for the Rector's selection of the institutions;</p> <p>2.5. To elect, re-elect and advance to the academic call the institution's academic</p>	<p>1. Senat je glavno kolegijalno akademsko telo javne institucije visokog obrazovanja. Senat ima primarnu odgovornost za donošenje odluka o akademskim pitanjima.</p> <p>2. Glavne obaveze i odgovornosti Senata su:</p> <p>2.1. Da štiti autonomiju institucije visokog obrazovanja, akademsku slobodu, kao i prava studenata;</p> <p>2.2. Odobrava statut institucije visokog obrazovanja pre njenog usvajanja od strane Upravnog odbora;</p> <p>2.3. Da bira članove Upravnog odbora koji su predloženi od strane institucije;</p> <p>2.4. Da objavi konkurs za rektora, prikuplja aplikacije, i sastavlja za Upravni odbor rang listu od dva (2) do tri (3) kandidata za odabir rektora te institucije;</p> <p>2.5. Da obavi izbor reizbor i unapredi akademska zvanja akademskom osoblju</p>

<p>akademik të institucionit;</p> <p>2.6. Të themelojë Komisionin e përhershëm për promovimin e personelit akademik për dhënien e titujve akademikë si edhe komisionet tjera të nevojshme për funksionimin e Senatit;</p> <p>2.7. Të hartojë politika zhvillimore akademike në bashkëpunim me rektorin;</p> <p>2.8. Të aprovojë hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e njësive akademike dhe programeve studimore dhe kërkimore-shkencore në përputhje me planin strategjik dhe buxhetin e institucionit;</p> <p>2.9. Të aprovojë planin vjetor të aktiviteteve akademike dhe kërkimore-shkencore/ artistike;</p> <p>2.10. Të propozojë kriteret për pranimin dhe regjistrimin e studentëve, në përputhje me Ligjin dhe aktet e brendshme të institucionit;</p> <p>2.11. Të vendosë për procedurën disiplinore ndaj studentëve dhe mësimitdhënësve;</p> <p>2.12. Të zgjedhë kryetarin e Senatit nga</p>	<p>staff;</p> <p>2.6. To establish a Permanent Commission for the promotion of academic staff for the granting of academic titles, as well as any other commissions necessary for the functioning of the Senate;</p> <p>2.7. To compile academic development policies in cooperation with the Rector.</p> <p>2.8. To approve the opening, reorganization and closure of academic units and of study and scientific research programs, in line with institution's strategic plan and its budget;</p> <p>2.9. To approve the annual plan of academic and research-scientific/artistic activities;</p> <p>2.10. To propose criteria for the acceptance and enrolment of students, in accordance with the Law and internal acts of the institution;</p> <p>2.11. To decide on disciplinary proceedings against students and teachers;</p> <p>2.12. To elect the Chairperson of the</p>	<p>institucije;</p> <p>2.6. Da osnuje stalnu komisiju za promovisanje akademskog osoblja za dodelu akademika zvanja, kao i druge komisije potrebne za funkcionisanje Senata;</p> <p>2.7. Da sastavi razvoju akademsku politiku sa rektorom</p> <p>2.8. Da odobri otvaranje reorganizaciju i zatvaranje akademskih jedinica i studijskih i naučno-istraživačkih programa, u skladu sa strateškim planom institucije i njenim budžetom;</p> <p>2.9. Da odobri godišnji plan akademskih i naučno-istraživačkih/umetničkih aktivnosti;</p> <p>2.10. Da predloži kriterijumi za prijem i upis studenata u skladu sa Zakonom i unutrašnjim aktima institucije;</p> <p>2.11. Da odlučuje o disciplinskim postupcima protiv studenata i nastavnika;</p> <p>2.12. Da izabere predsedavajućeg Senata</p>
---	--	--



<p>radhët e anëtarëve të vet;</p> <p>2.13 .Të shqyrtojë çështjet me kërkesë të Këshillit drejtues, rektorit dhe kërkesat tjera që vijnë në Senat.</p> <p>3. Funksionet tjera të Senatit përcaktohen në statutin e institucionit të arsimit të lartë.</p> <p>4. Anëtarët e Senatit zgjidhen nga radha e personelit akademik dhe studentëve. Nuk mund të jenë anëtarë të Senatit, zyrtarët ekzekutiv të emëruar brenda institucionit: Rektori, prorektorët, dekanët, prodekanët dhe personat tjerë që mbajnë poste ekzekutive. Të paktën 15% e anëtarëve të Senatit me të drejtë vote duhet të jenë nga radhët e studentëve, të cilët nuk kanë të drejtë vote në rastet e avancimit dhe zgjedhjes së personelit akademik.</p> <p>5. Të paktën gjysma e anëtarëve të Senatit nga personeli akademik i njësive akademike duhet të jenë profesorë të rregullt dhe gjysma tjetër profesor të asociuar. Në mungesë të kandidatëve me tituj të profesorit të rregullt, kandidatët mund të zgjidhen edhe nga personeli akademik me titullin më të lartë akademik në njësitë akademike përkatëse.</p> <p>6. Mandati i anëtarëve akademikë të Senatit</p>	<p>Senate from among its members;</p> <p>2.13. To review matters at the request of the Steering Council, the Rector and other requests coming to the Senate</p> <p>3. Other functions of the Senate are determined by the statute of the higher education institution.</p> <p>4. Senate members are elected from among the academic staff; the non-academic staff and students. Rector, Vice-Rectors, Deans and other staff holding executive positions within the institution cannot be members of the Senate. At least 15% of the Senate members with voting right must be from students, who do not have the right to vote in cases of advancement and selection of academic staff.</p> <p>5. At least half of the members of the Senate from academic staff must be Full Professors and the other half should be associated professors. In the absence of candidates with the titles of Full Professors, candidates may also be selected from the academic staff with the highest academic title in the respective academic units.</p> <p>6. The mandate of academic and non-</p>	<p>iz redova svojih članova;</p> <p>2.13. Da razmotri pitanje na zahtev Upravnog odbora, rektora i druge zahteve koje dolaze u Senat-</p> <p>3. Ostale funkcije Senata su utvrđene statutom institucije visokog obrazovanja.</p> <p>4. Članovi Senata se biraju iz redova akademskog osoblja, i studenata. Ne mogu biti članovi Senata izvršni službenici imenovanih unutar institucije: Rektor, prorektor, dekan, prodekan i ostalo osoblje koje je na izvršnim položajima. Najmanje 15% članova Senata sa pravom glasa treba da budu iz redova studenata, koji nemaju pravo glasa u slučaj unapređenja i odabir akademskog osoblja.</p> <p>5. Najmanje polovina članova Senata iz akademskog osoblja treba da budu redovni profesori i polovina vanredni profesori U odsustvu kandidata sa zvanjem redovnog profesora, kandidati takođe mogu biti izabrani iz akademskog osoblja sa najvišim zvanjem u odgovarajućim akademskim jedinicama.</p> <p>6. Mandat akademskih i ne-akademskih</p>
--	---	---

<p>është katër (4) vite. Mandati i anëtarëve nga radha e studentëve është një (1) vit, pa të drejtë të rizgjedhjes. Mandati i anëtarëve të Senatit fillon me vitin e ri akademik.</p> <p>7. Numri dhe mënyra e zgjedhjes, shkarkimit dhe zëvendësimit të anëtarëve të Senatit të cilëve u ka pushuar mandati rregullohet me statutin e institucionit.</p> <p>8. Senati mbledhet periodikisht dhe mund të marrë vendime në mbledhje ku marrin pjesë më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Senatit me të drejtë vote. Vendimi merret me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm me të drejtë vote, përveç rasteve të tjera kur përcaktohet në statutin e institucionit.</p> <p>9. Për çështjet që kanë të bëjnë me ndryshimet e statutit, zgjedhjen e organeve të institucionit, komisioneve të Senatit, nismën për shkarkimin e rektorit, prorektorëve, dekanëve apo prodekanëve, Senati mund të vendos nëse në seancë marrin pjesë së paku 2/3 nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Senatit me të drejtë vote, ndërsa merr vendim me shumicën e përgjithshme të anëtarëve të pranishëm.</p>	<p>academic members of the Senate is four (4) years. The mandate of student members shall be one (1) year, without the right to re-election. The mandate of the members of the Senate begins with the new academic year.</p> <p>7. The number and method of elections, dismissals and replacements of members of the Senate whose mandate was terminated is regulated by the statute of the institution.</p> <p>8. The Senate meets regularly as needed and can make decisions in meetings attended by more than half of the total number of Senate members with the right to vote. The decision shall be taken by majority votes of the members present who have the right of voting, except when otherwise provided by the statute of the institution</p> <p>9. For matters relating to amendments of the statutes, the election of institutional bodies, senate commissions, initiative for dismissal of the Rector, Pro-Rectors, Deans and Vice-Deans, the Senate can decide if at least 2/3 of the total number of members of the Senate participate in the session, while takes decision with the general majority of the members present.</p>	<p>članova Senata je četiri (4) godine. Mandat članova iz redova studenata je jedna (1) godina, bez prava na ponovno biranje. Mandat članova Senata počinje novom akademskog godinom.</p> <p>7. Broj i način biranja, razrješavanje i izmene članova senata kojima je prestao mandat se regulišu statutom institucije.</p> <p>8. Senat se sastaje redovno i po potrebi i može donositi odluke na sednice kojima prisustvuje više od polovine ukupnog broja članova Senata sa pravom glasa. Odluka se donosi većinom glasova prisutnih članova koji imaju pravo glasanja, osim u drugim slučajevima kada je to predviđeno statutom ustanove.</p> <p>9. Za pitanja koja se odnose na izmeni statuta, biranje organa institucije, komisija senata, inicijative za razrješavanje rektora, prorektora, dekana ili prodekana, Senat može da odluči ukoliko na sednici učestvuje najmanje 2/3 ukupnog broja članova senata sa pravom glasa, i odlučuje prostom većinom prisutnih članova .</p>
---	--	---

<p style="text-align: center;"><b>Neni 24 Rektori</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 24 The Rector</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 24 Rektor</b></p>
<p>1. Autoriteti më i lartë menaxherial i një institucioni publik të arsimit të lartë është Rektori, i cili është përfaqësuesi ligjor për çështjet akademike dhe protokollare, sipas përcaktimeve të këtij Ligji.</p> <p>2. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të rektorit janë:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1. Të veprojnë në emër të institucionit dhe ta përfaqësojnë atë para publikut dhe më gjerë;</p> <p style="padding-left: 20px;">2.2. Të organizojë, drejtojë dhe menaxhojnë burimet njerëzore, fizike dhe financiare të institucionit;</p> <p style="padding-left: 20px;">2.3. Të hartojë planin strategjik të zhvillimit të institucionit të arsimit të lartë, në bashkëpunim me Senatin dhe ia përcjell atë Këshillit drejtues për miratim final;</p> <p style="padding-left: 20px;">2.4. Të përgatisë një draft të statutit si dhe draftet e ndryshimeve në statut për dorëzim te Senati dhe Këshilli drejtues;</p>	<p>1. The highest executive and managerial authority of a public higher education institution is the Rector, who is also the legal representative for academic and protocol issues, according to specifications of this Law.</p> <p>2. Main duties and responsibilities of the Rector are:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1. To act on behalf of the institution and to represent it before the public and beyond;</p> <p style="padding-left: 20px;">2.2. To organize, direct and manage the institution's human, physical and financial resources;</p> <p style="padding-left: 20px;">2.3. To compile the strategic plan for the development of the higher education institutions in cooperation with Senate and submit it to the Steering Council for the final approval;</p> <p style="padding-left: 20px;">2.4. To prepare a draft statute as well as drafts of changes to the statute for submission to the Senate and the Steering Council;</p>	<p>1. Najviši izvršni i upravni organ jedne javne institucije visokog obrazovanja je Rektor, koji je također i pravni zastupnik za akademska i protokolarna pitanja, u skladu sa specifikacijama ovog Zakona.</p> <p>2. Glavne obaveze i odgovornosti rektora su:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1. Da deluje u ime institucije i da istu zastupa pred javnošću i šire;</p> <p style="padding-left: 20px;">2.2. Da organizuje, vodi i upravlja institucijom, njenim ljudskim, fizičkim i finansijskim resursima;</p> <p style="padding-left: 20px;">2.3. Da pripremi strateški plan za razvoj institucije visokog obrazovanja u saradnji sa Senatom i dostavlja isti pred Upravnog odbora za konačno odobrenje;</p> <p style="padding-left: 20px;">2.4. Da pripremi nacrt statuta kao i predložene izmene statuta za podnošenje Senatu i Upravni odbor;</p>

<p>2.5. Të emëroj dekanët pas propozimit nga Këshilli i fakultetit. Dekan emërohet kandidati që ka marrë numrin më të madh të votave në Këshill. Në rast të shkarkimit përsëritet procedura e njëjtë;</p> <p>2.6. Të shkarkoj dekanin në rast të dështimit të përmbushjes së detyrave që janë të përcaktuara me ligj dhe statut të IAL, dhe të kërkoj nga njësia akademike të propozoj kandidatin tjetër sipas procedurës së njëjtë;</p> <p>2.7. Të punësojë, delegojë, nivelizojë, promovojë, suspendojë dhe përcaktojë kushtet e punës për personel në pajtim me rregulloret e nxjerra nga Senati, Këshilli drejtues dhe në respektim të plotë të detyrave dhe të drejtave të Senatit në raport me kuadrin akademik;</p> <p>2.8. Të paraqesë para Këshillit drejtues propozime në përputhje me misionin e institucionit duke marrë parasysh rekomandimet dhe mendimin e Senatit;</p> <p>2.9. Të vendos një sistem të brendshëm për sigurimin e cilësisë dhe procedurat e llogaridhënies dhe raportimit në përputhje me ligjet në fuqi;</p>	<p>2.5. To appoint Deans upon proposal by the Faculty Council. The dean is appointed as the candidate who has received the highest number of votes in the Council. In case of dismissal the same procedure is repeated.</p> <p>2.6. To discharge the dean in case of failure to perform duties as set out by law and statute of HEI, and ask from the academic unit to propose other candidates under the same procedure</p> <p>2.7. To employ, delegate, level, promote, suspend and define terms of work for personnel in compliance with issued regulations by the Steering Council and in full observance of the duties and rights of the Senate with respect to academic staff;</p> <p>2.8. To present before the Steering Council proposals in accordance with the institution's mission, taking into account the Senate's recommendations and opinion;</p> <p>2.9. To set an internal quality assurance system and accountability and reporting procedures in accordance with laws in force;</p>	<p>2.5. Da imenuje dekane na predlog Savet fakulteta. Dekan se imenuje kandidat koji je dobio najveći broj glasove Saveta. U slučaju razrešenja ponavlja se isti postupak.</p> <p>2.6. Razrešiti dekana u slučaju ne izvršavanja dužnosti utvrđenih zakonom i statutom IVO-a, i zatražiti od akademske jedinice da predloži druge kandidate po istom postupku.</p> <p>2.7. Da zaposli, delegira, izjednačava, promoviše, suspenduje i odredi uslove rada za osoblje u skladu sa pravilima senata, Upravnog odbora odbor i potpuno poštovanje zadaci i obaveze senata sa akademskim osobljem;</p> <p>2.8. Da predloži ispred Upravni odbor predloge u skladu sa misijom institucije, uzimajući u obzir preporuke i mišljenje Senata;</p> <p>2.9. Da uspostavi unutrašnje kontrole za obezbeđivanje kvaliteta i procedure odgovornosti i izvještavanja u skladu sa važećim zakonom;</p>
--	---	---

<p>2.10. Të hartojë dhe prezentojë raportin vjetor të buxhetit për të hyrat dhe shpenzimet para Këshillit drejtues;</p> <p>2.11. Të hartojë raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë dhe performancës së institucionit dhe ia përcjell atë Këshillit drejtues për miratim;</p> <p>2.12. Të negociojë me ministrin një draft të kontratës kornizë shumëvjeçare lidhur me performancën për dërgim tek Këshilli drejtues për aprovim dhe nënshkruajë kontratën me ministrin;</p> <p>2.13. Të nënshkruajë kontrata me palët e treta në emër të institucionit;</p> <p>2.14. Të nënshkruajë diplomat dhe certifikatat e tjera zyrtare të institucionit;</p> <p>2.15. Të shpallë të gjithë titujt akademikë.</p> <p>3. Rektori ka kompetencë për iniciimin e procedurave për shkarkimin e zyrtarëve menaxhues të njëjësive akademike dhe organizative në përputhje me Ligjin dhe me statutin e institucionit.</p> <p>4. Funkcionet tjera të rektorit përshkruhen në</p>	<p>2.10.To compile and present the annual budget report for the incomes and expenditures to the Steering Council;</p> <p>2.11.To draft a detailed annual plan on the activity and performance of the institution and forwards it to the Steering Council for approval;</p> <p>2.12.To negotiate with the Minister a multi-year framework draft contract that is related to the performance and to be sent to the Steering Council for approval and to sign the contract with the Minister;</p> <p>2.13.To sign contracts on behalf of the institution with the third parties;</p> <p>2.14.To sign diplomas and other official certificates of the institution;</p> <p>2.15.To declare all academic titles;</p> <p>3. The Rector has competence to initiate the procedure for discharge of executive officials of the academic and organisational units in compliance with the Law and with the statute of the institution.</p> <p>4. Other functions of the Rector are</p>	<p>2.10. Da priprema i predstavi godišnji izveštaj budžeta za prihode i rashod ispred Upravni odbor;</p> <p>2.11. Da izradi detaljni godišnji plan o aktivnostima i učinku institucije i dostavlja isti Upravnome odboru na usvajanje;</p> <p>2.12. Da pregovara sa ministrom o nacrtu višegodišnjeg nacrta okvira ugovora u vezi performanse za dostavljanje Upravnome odboru na usvajanje, i da potpiše ugovor sa ministrom;</p> <p>2.13. Da potpisuje ugovore u ime institucije sa trećim stranama;</p> <p>2.14. Da potpiše diplome i druge službene certifikate institucije;</p> <p>2.15. Da objavi sva akademska zvanja;</p> <p>3. Rektor ima ovlašćenje da pokrene procedure za razrešenje izvršnih zvaničnika akademskih i organizacionih jedinica u skladu sa Zakonom i Statutom institucije.</p> <p>4. Druge funkcije rektora se opisuju u</p>
--	--	---

<p>statutin e institucionit të arsimit të lartë.</p> <p>5. Kandidati për rektor duhet të mbajë titullin e profesorit të rregullt, profesorit të asociuar, profesorit asistent ose të barasvlefshme, të fituar nga një institucion i arsimit të lartë. Rektori zgjidhet për një mandat katërvjeçar, me të drejtë të rizgjedhjes edhe për një mandat tjetër . Të drejtën e paraqitjes në konkurs e kanë edhe kandidatët që nuk janë në marrëdhënie pune në institucionin që ka shpallur konkursin.</p> <p>6. Senati përpilon listën e kandidatëve që i plotësojnë kushtet e konkursit dhe u jep mundësinë atyre që programi i tyre i punës të prezantohet tek njësitë akademike dhe Senati. Kandidatët që fitojnë mbështetjen e të paktën 25% të këshillave të njësive akademike për zgjedhje në postin e rektorit hyjnë në listën e ngushtë të kandidatëve. Njësia akademike përcaktohet vetëm për një kandidat.</p> <p>7. Senati nga lista e ngushtë e kandidatëve, me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të Senatit, nxjerr një listë me dy (2) deri në tre (3) kandidatë për rektor. Nëse asnjëri nga kandidatët nuk e fiton shumicën e duhur të votave pas tri (3) raundeve të votimit, procedura zgjedhore përsëritet.</p>	<p>described in the statute of the higher education institution.</p> <p>5. A candidate for Rector must have the title of Full Professor, associated professor, assistant professor or equivalent, earned by a higher education institution. The rector is elected for a four-year mandate with the right to re-election for another mandate. The right for submission to a competition have also candidates who are not employed at the institution that has announced the competition.</p> <p>6. The Senate compiles the list of candidates that meet the contest conditions and gives them the opportunity that their program is presented to the academic units and the Senate. The candidates that earn support of at least 25% of the councils of the academic units for election of the Rector enter the candidates' shortlist. The academic unit is determined only for one candidate</p> <p>7. The Senate from the shortlist of candidates, with majority of votes of all Senate members, draws up a list of two (2) to three (3) candidates for Rector. If none of the candidates gains the required majority of votes after three (3) rounds of voting, the election procedure is repeated.</p>	<p>statutima institucija visokog obrazovanja.</p> <p>5. Kandidat za rektora treba da poseduje zvanje redovnog profesora, vanrednog profesora, profesor asistent ili ekvivalentom, stečeno u institucijama visokog obrazovanja. Rektor se bira za fiksni mandat od četiri godine, sa pravom ponovnog biranja za još jedan mandat. Pravo prijave na konkursu imaju i kandidati koji nisu u radnom odnosu u instituciji koja je objavila konkurs.</p> <p>6. Senat sastavlja listu kandidata koji ispunjavaju uslove konkursa i daje im mogućnost da njihov program predstave pred akademskim jedinicama i pred Senatom. Kandidati koji dobiju podršku od najmanje 25% akademskih jedinica za biranje na poziciji rektora ulaze na užoj listi kandidata. Akadmeske jedinice se odlučuju samo za jednog kandidata.</p> <p>7. Senat sa uže liste kandidata, većinom glasova svih članova Senata, rangira na listu dva (2) do tri (3) kandidata za rektora. Ukoliko nijedan od dvoje kandidata ne dobije odgovarajuću većinu glasova nakon tri (3) runde glasanja, izborna procedura se ponavlja.</p>
--	---	--

<p>8. Këshilli drejtues zgjedhë rektorin e institucionit nga kjo listë, me 2/3 e votave në dy votimet e para të të gjithë anëtarëve të Këshillit drejtues. Në votimin e tretë, kandidati mund të zgjidhet me shumicën e përgjithshme të votave. Nëse asnjëri nga kandidatët e nominuar nuk e fiton shumicën e duhur të votave pas tri (3) raundeve të votimit, procedura zgjedhore përsëritet.</p> <p>9. Rektori mund të emërojë një apo më shumë prorektorë dhe u beson atyre një fushë të veçantë të përgjegjësisë. Numri i prorektorëve, emërtimi dhe detyrat e tyre rregullohen me statutin e institucionit. Mandati i prorektorëve lidhet me mandatin e rektorit, por mund të shkarkohen edhe para skadimit të mandatit me vendimin e rektorit.</p> <p>10. Këshilli drejtues i institucionit të arsimit të lartë mund të shkarkojë rektorin me 2/3 e votave të gjithë anëtarëve të Bordit në rast të shkeljeve të rënda të detyrave, të tilla si:</p> <p>10.1. Dënimi për një vepër të rëndë të dënueshme ;</p> <p>10.2. Paaftësia për të kryer funksionet e postit të tij/saj për shkak të paaftësisë fizike apo mendore, të dokumentuara në</p>	<p>8. The Rector of the institution is chosen by the Steering council from this list, with 2/3 of the votes in the first two votings of all members of the Steering Council. In the third voting, the candidate may be elected by a general majority of votes. If none of the nominated candidates earns the right majority of votes after three (3) voting rounds, the election procedure is repeated.</p> <p>9. The Rector may appoint one or more Vice-Rectors and entrust them a specific area of responsibility. The number of Vice-Rectors, their appointment and their duties are regulated with the statute of institution. The Vice-Rectors mandate is bound to the Rector's mandate, but they can be discharged even before the expiration of the mandate by decision of the Rector.</p> <p>10. The Steering Council of the institution of higher education may discharge the Rector with 2/3 of the votes of all members of the Board in case of severe duty violations such as:</p> <p>10.1. Conviction for a serious punishable offense;</p> <p>10.2. Inability to perform the functions of its post due to physical or mental disability, documented in a report by a group of</p>	<p>8. Upravni odbor bira rektor institucije sa ovog spiska, sa 2/3 glasova na prva dva glasanja ispred svih članova Upravnog odbora. U treći krug glasanja kandidat može biti izabran opštom većinom glasova. Ako nijedan nominovan kandidat ne dobije potrebnu većinu glasova nakon tri (3) runde glasanja, izborna procedura se ponavlja.</p> <p>9. Rektor može imenovati jednog ili više prorektora i da im poveri posebnu oblast odgovornosti. Broj prorektora, njihovo imenovanje i njihove obaveze se regulišu statutom institucije. Mandat prorektora se povezuje sa mandatom rektora, ali se odlukom rektora mogu razrešiti i pre isteka mandata.</p> <p>10. Upravni odbor institucije visokog obrazovanja može razrešiti rektora sa 2/3 glasova svih članova Odbora u slučaju teškog kršenja dužnosti, kao što su:</p> <p>10.1 Kazna za teško kažnjivo krivično delo;</p> <p>10.2 Nesposobnost da obavlja funkcije svoje pozicije zbog fizičke ili mentalne nesposobnosti, dokumentovano u izveštaju</p>
--	--	---

<p>një raport nga një grup mjekësh, të emëruar sipas ligjeve në fuqi;</p> <p>10.3. Shkeljet e rënda të këtij Ligji dhe statutit të institucionit të arsimit të lartë.</p> <p>11. Iniciativa për shkarkimin e Rektorit mund të ndërmerret nga Senati i institucionit. Në rast të një iniciative të tillë, Këshilli drejtues është i obliguar që të shqyrtojë propozimin brenda 30 ditësh.</p> <p>12. Në rast të përfundimit të parakohshëm të mandatit të Rektorit për çfarëdo arsye, Senati shpall zgjedhje të parakohshme për pozitën e tij, brenda gjashtë (6) muajve nga data e përfundimit të parakohshëm të mandatit dhe Këshilli drejtues emëron një ushtrues detyre për një periudhë prej gjashtë (6) muajsh.</p> <p>13. Çështjet e tjera rreth zgjedhjes, shkarkimit dhe pushimit të parakohshëm të mandatit të Rektorit përcaktohen me statutin e institucionit.</p>	<p>physicians, appointed under the applicable laws;</p> <p>10.3. Severe violations of this Law and the statute of the higher education institution;</p> <p>11. The initiative for the dismissal of the Rector can be undertaken by the Senate of the institution. In case of such initiative, the Steering Council is obliged to review the proposal within 30 days.</p> <p>12. In case of early termination of the Rector's mandate for any reason, the Senate announces early elections for the position of Rector, within six (6) months from the date of early termination of the mandate and the Steering Council appoints a Vice-Rector for a period of six (6) months.</p> <p>13. Other issues regarding the election, discharge and premature termination of the Rectors' mandate are defined by the statute of the institution.</p>	<p>grupe lekara, imenovanih u skladu sa važećim zakonima;</p> <p>10.3 Ozbiljne povrede ovog Zakona i statuta institucije visokog obrazovanja;</p> <p>11. Inicijativu za razrešenje rektora može pokrenuti Senat institucije. U slučaju ovakve inicijative, Upravni odbor je dužan da razmotri predlog u roku od 30 dana.</p> <p>12. U slučaju prevremenog prestanka mandata rektora iz bilo kog razloga, Senat objavljuje privremene izbore za poziciju rektora, u roku od šest (6) meseci od dana prevremenog prestanka mandata i Upravni odbor imenuje vršioca dužnosti za period od šest (6) meseci.</p> <p>13. Ostala pitanja u vezi sa izbornom, razrešenjem i prevremenom prestanku mandata rektora definirani su statutom institucije.</p>
---	--	---



<b>KAPITULLI VII: PERSONELI I INSTITUCIONEVE PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË</b>	<b>CHAPTER VII: THE PERSONNEL OF PUBLIC INSTITUTIONS OF HIGHER EDUCATION</b>	<b>POGLAVLJE VII: OSOBLJE JAVNE INSTITUCIJE VISOKOG OBRAZOVANJA</b>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 25</b> <b>Kushtet e përgjithshme për punësim të personelit</b></p> <p>1. Personeli i institucioneve publike të arsimit të lartë përbëhet nga personeli akademik dhe personeli administrativ.</p> <p>2. Personeli i institucioneve publike të arsimit të lartë mund të jetë i punësuar me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar ose të caktuar, si edhe me angazhim me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme.</p> <p>3. Të drejtat dhe detyrimet e personelit të institucioneve publike të arsimit të lartë përcaktohen në statutet dhe kontratat e tyre individuale, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p> <p>4. Çdo institucion i arsimit të lartë, mund të emërojë stafin e posaçëm për pozita mësimdhënëse, hulumtuese dhe administrative ose teknike. Institucioni në statutin e tij do të specifikojë titujt e personelit të posaçëm kërkimor, mësimor, të</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 25</b> <b>General conditions for personnel employment</b></p> <p>1. The personnel of public higher education institutions of consist of academic personnel and administrative personnel.</p> <p>2. The personnel of public higher education institutions can be employed with indefinite or definite duration of the contract, as well as with full-time or part-time engagement.</p> <p>3. The rights and obligations of the personnel of higher public education institutions are defined in the statutes and in their individual contract, in accordance with legal and sub-legals acts in force.</p> <p>4. Each higher education institution may appoint special staff for teaching, research, administrative or technical positions. The institution in its statute shall specify the titles of special research personnel, curriculum, and senior administrative and technical personnel,</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 25</b> <b>Opšti uslovi za zapošljavanje osoblja</b></p> <p>1. Osoblje javnih institucija visokog obrazovanja se sastoji od akademsko osoblje i administrativnog osoblja.</p> <p>2. Osoblje javnih institucija visokog obrazovanja može imati ugovor neograničenog trajanje ili ugovor ograničenog trajanja, kao i angažovane sa punu radno vreme ili skraćeno radno vreme.</p> <p>3. Prava i obaveze osoblja u javnim institucijama visokog obrazovanja su definisani u statutima i u njihovim pojedinačnim ugovorima, u skladu sa važećim zakonskim aktima i pod-zakonskim aktima.</p> <p>4. Svaka institucija visokog obrazovanja može imenovati posebno osoblje na pozicijama predavača, istraživače, administrativne ili tehničke pozicije. Institucija u svom statutu treba navesti zvanja specijalnog istraživačkog osoblja, nastavnici</p>

<p>personelit të lartë administrativ dhe të atij teknik, së bashku me kriteret për zhvillimin profesional, promovimin dhe avancimin brenda këtyre fushave të punës.</p> <p>5. Emërimi si staf i rregullt apo i angazhuar për pozita mësimdhënëse, ndalohet në ato raste kur brenda të njëjtës njësi akademike apo fakultet kanë të punësuar persona në marrëdhënie familjare siç përcaktohet me këtë ligj.</p> <p>6. Përvec pikës 5, legjislacioni për parandalimin e konfliktit të interesit zbatohet gjithashtu në çdo rast të punësimit.</p>	<p>along with criteria for professional development, promotion and advancement within these areas of work.</p> <p>5. Appointment as a regular or engaged staff for teaching positions is prohibited in those cases where within the same academic unit or faculty have employed persons in family relations as defined by this Law.</p> <p>6. In addition to point 5, the law on conflict prevention is also applicable in every case of employment</p>	<p>plan i program, i više administrativno i tehničko osoblje, zajedno sa kriterijuma za profesionalni razvoj, promociju i napredovanje u ovim oblastima rada.</p> <p>5. Imenovanje redovnog ili angazovanog osoblja za nastavnine pozicije zabranjeno je u slučajevima kada su u okviru iste akademske jedinice ili fakulteta imaju zaposlene osobe koje su u porodičnoj vezi kao što je definisano ovim zakonom.</p> <p>6. Pored tačke 5, zakon o sprečavanju sukoba interesa se takođe primjenjuje u svim slučajevima zapošljavanja</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 26</b> <b>Standardet minimale për emërimet akademike</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 26</b> <b>Minimum Standards for Academic Appointments</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 26</b> <b>Minimalni standardi za akademska imenovanja</b></p>
<p>1. Personeli akademik mund të jetë i orientuar drejt arsimit dhe/ose hulumtimit dhe zhvillimit, dhe/ose shkencave të aplikuara dhe inovacionit.</p> <p>2. Personeli akademik përbëhet nga personeli që mban një titull akademik (profesorë të rregullt, profesorë të asociuar dhe profesorë asistentë), siç përcaktohet në nenin 27 të këtij Ligji, dhe të llojeve të ndryshme të asistentëve me kohë të plotë dhe të pjesshme</p>	<p>1. The academic personnel can be oriented towards education and/or research and/or applied sciences and innovation.</p> <p>2. The academic personnel consists from the personnel holding an academic title (Full Professors, associate professors and assistant professors), as defined in article 27 of this Law, and of various types of full-time and part-time assistants, as well as for a short</p>	<p>1. Akademske osoblje može biti orijentisano ka obrazovanju i/ili istraživanju i/ili primenjene nauke i inovacijama.</p> <p>2. Akademske osoblje se sastoji od osoblja koji nosi akademsko zvanje (redovni profesori, vanredni profesori i asistenti profesora), kao što je definisano u članu 27. ovog Zakona, i raznih vrsti asistenata sa punim i delimičnim radnim vremenom, kao i</p>

<p>si dhe mësimdhënësit /studiuesit të ftuar për një afat të shkurtër.</p> <p>3. Institucionet e arsimit të lartë dhe njësitë e tyre akademike, kanë të drejtë të punësojnë studiues, personalitete të kualifikuara, artistë vendas ose të huaj me kontratë për periudha të shkurtra kohore si personel akademik i ftuar nga jashtë. Përzgjedhja e personelit akademik të ftuar bëhet duke i kombinuar kualifikimet e tyre me nevojën themelore të njësisë për mësimdhënie ose veprimtari kërkimore-shkencore/artistike. Personeli i ftuar angazhohet sipas specifikave të përcaktuara në statutin dhe rregulloret e arsimit të lartë. Shpenzimet për personelin akademik të ftuar mbulohen nga të ardhurat e institucionit ose siç është rënë dakord ndërmjet institucioneve.</p> <p>4. Personeli akademik i kategorisë “Profesor i rregullt”, “Profesor i asociuar” dhe “Profesor asistent”, me aprovimin nga njësia akademike ku ai/ajo kryen veprimtari akademike, ka të drejtë të shkëputet nga angazhimi në institucion, një herë në pesë (5) vite për periudha deri në një (1) vit, me qëllim të avancimit të tij/saj akademik. Ky vit njihet si vit akademik sabbatik. Mënyra e rregullimit të marrëdhënieve ligjore në mes të palëve në këtë periudhë, përcaktohet në statutin e institucionit të arsimit të lartë.</p>	<p>term invited teachers/scholars.</p> <p>3. Higher education institutions and their academic units are entitled to hire scholars, qualified personalities, local or foreign artists with contract for short periods of time as academic personnel invited from abroad. The selection of the invited academic personnel is conducted by combining their qualifications with the basic unit need for teaching or research-scientific/artistic activities. The invited personnel are hired according to specifications in the statute and regulations of higher education. Expenditures for invited academic personnel are covered by the incomes of institution or as agreed among institutions.</p> <p>4. The academic personnel of the category “Full Professor”, “Associated Professor” and “Assistant Professor”, with the approval from the academic unit where he/she performs academic activity, is entitled to secede from the engagement in the institution once in five (5) years for periods up to one (1) year, in order to work for his/her academic advancement. This year is known as academic sabbatical year. The manner of regulating legal relations between the parties in this period is defined in the statute of the</p>	<p>kratkoročno pozvani nastavnici/naučnici.</p> <p>3. Institucije visokog obrazovanja i njihove akademske jedinice imaju pravo da zaposle istražioce, kvalifikovanog osoblja strane ili domaće umetnike sa ugovorom za kratke vremenske periode kao akademsko osoblje pozvano iz inostranstva. Izbor pozvanog akademskog osoblja se sprovodi kombinacijom njihovih kvalifikacija sa osnovnim potrebama jedinice za nastavu ili naučno-istraživačke aktivnosti. Pozvano osoblje se angažuju u skladu sa specifikacijama u statutu i uredbama visokog obrazovanja. Troškovi za pozvano akademsko osoblje su pokriveni prihodima institucije ili kako je dogovoreno između institucija.</p> <p>4. Akademsko osoblje kategorije "redovni profesor", "vanredni profesor" „i "asistent profesora",uz odobrenje akademske jedinice, gde on/ona obavlja akademske aktivnosti, ima pravo da se otcepi od angažovanja u instituciji jednom u pet (5) godina za periode do jedne (1) godine, da radi za njegov/njen akademski napredak. Ova godina se priznaje kao akademska godina sabata. Način regulisanja pravnih odnosa između strana u ovom periodu je određuje se u statutu institucije visokog obrazovanja</p>
--	--	---

<p>marrëdhënie juridike me atë institucion.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 33</b> <b>Të drejtat dhe detyrimet e studentëve</b></p> <p>1. Studentët që janë pranuar dhe regjistruar në institucionin e arsimit të lartë kanë të drejtat e mëposhtme, që mund të specifikohen më tej në statutin e institucionit:</p> <p>1.1. Të ndjekin të gjitha veprimtaritë mësimore që zhvillohen në kuadër të programit të studimit ku ata janë regjistruar;</p> <p>1.2. Të përdorin infrastrukturën që institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të procesit mësimor si dhe të përfitojnë nga shërbimet mbështetëse që ofrohen nga ai institucion;</p> <p>1.3. Të marrin pjesë në proceset e vendimmarrjes së institucionit të arsimit të lartë në përputhje me përcaktimet e këtij Ligji dhe statutin e institucionit;</p> <p>1.4. Të marrin pjesë në zgjedhjet për pozitat e studentëve në organizmat e ngritur mbi bazën e statutit të institucionit;</p>	<p>relationship with that institution.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 33</b> <b>Rights and obligations of the students</b></p> <p>1. Students that are accepted and enrolled in a higher education institution have the following rights, which can be specified further in the statutes of the institution:</p> <p>1.1. To attend all learning activities which are conducted within the study program where they are registered;</p> <p>1.2. To use the infrastructure made available for the teaching process by the higher education institutions, as well as to benefit from supporting services offered from that institution;</p> <p>1.3. To participate in decision-making processes of higher education institution in accordance with the specifications of this Law and the statute of the institution;</p> <p>1.4. To take part in elections for the students' posts in the bodies established on the basis of the institution's statute;</p>	<p>odnose sa tom institucijom.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 33</b> <b>Prava i obaveze studenata</b></p> <p>1. Studenti koji su primljeni ili registrovani u jednoj instituciji visokog obrazovanja imaju sledeća prava, koja se mogu dalje precizirati u statutu institucije:</p> <p>1.1. Da pohađaju sve nastavne aktivnosti koje se sprovode u okviru studijskog programa u kome su registrovani;</p> <p>1.2. Da koriste infrastrukturu na raspolaganju za nastavni proces od strane institucije visokog obrazovanja, kao i koriste podršku pruženih usluga iz te institucije;</p> <p>1.3. Da učestvuju u procesima donošenja odluka institucije visokog obrazovanja u skladu sa specifikacijama ovog Zakona i statutom institucije;</p> <p>1.4. Da učestvuju u izborima za pozicije studenata u organima koji su uspostavljeni na osnovu statuta institucije;</p>
---	--	--

<p>1.5. Të shprehin vlerësimin e tyre për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit në institucionin e arsimit të lartë.</p> <p>2. Studentët kanë detyrimet si në vijim:</p> <p>2.1. Të zbatojnë rregullat e përcaktuara nga institucioni i arsimit të lartë;</p> <p>2.2. Të respektojnë të drejtat e personelit dhe të studentëve të tjerë;</p> <p>2.3. T'i kushtojnë vëmendjen e duhur e të plotë studimeve dhe të marrin pjesë në aktivitetet akademike;</p> <p>2.4. Të paguajnë tarifatat e përcaktuara nga Ministria dhe nga institucionet e arsimit të lartë si dhe tarifatat e shërbimeve që u ofrojnë institucionet e arsimit të lartë;</p> <p>2.5. Të respektojnë Kodin e Etikës së institucionit të arsimit të lartë.</p> <p>3. Në statutin e institucionit mund të përcaktohen të drejta dhe detyra të tjera të studentëve.</p> <p>4. Statuti i çdo institucioni të arsimit të lartë përmban dispozita, të cilat:</p>	<p>1.5. To express their assessment regarding the teaching quality and the work of the personnel of the higher education institution;</p> <p>2. Students have the following obligations:</p> <p>2.1. To observe the rules determined by the higher education institution;</p> <p>2.2. To respect the rights of the personnel and other students;</p> <p>2.3. To pay proper and complete attention to studies and to take part in academic activities;</p> <p>2.4. To pay fees determined by the Minister and higher education institutions, as well as fees of services provided by higher education institutions;</p> <p>2.5. To respect the Code of Ethics of the higher education institution.</p> <p>3. Other rights and obligations of the students can be determined in the institution's statute.</p> <p>4. The statute of every higher education institution contains provisions, which:</p>	<p>1.5. Da izraze svoje procene u pogledu kvaliteta predavanja i rada osoblja institucije visokog obrazovanja;</p> <p>2. Studenti imaju sledeće obaveze:</p> <p>2.1. Da poštuju pravila određena od strane institucije visokog obrazovanja;</p> <p>2.2. Da poštuju prava osoblja i drugih studenata;</p> <p>2.3. Da posvete adekvatnu i potpunu pažnju studijama i da učestvuju u akademskim aktivnostima;</p> <p>2.4. Da plate naknade utvrđene od strane ministarstva i institucija visokog obrazovanja, kao i naknade za usluge koje pružaju institucije visokog obrazovanja;</p> <p>2.5. Da poštuju kodeks etike institucije visokog obrazovanja.</p> <p>3. U statutu institucije se mogu utvrditi i druga prava i obaveze studenata.</p> <p>4. Statut svake institucije visokog obrazovanja sadrži odredbe, koje:</p>
---	--	--

<p>4.1. Garantojnë lirinë e studentëve brenda ligjit për të paraqitur ide të reja dhe opinione të debatueshme pa rrezikuar humbjen e vendit të studentit ose privilegjet që mund të gëzojnë nga institucioni;</p> <p>4.2. Garantojnë lirinë e fjalës, të organizimit e të tubimit sipas dispozitave ligjore;</p> <p>4.3. Mbrojnë studentët nga çdo lloj diskriminimi;</p> <p>4.4. Sigurojnë mekanizma të paanshëm dhe objektivë për trajtimin e çështjeve disiplinore që kanë të bëjnë me studentët.</p> <p>5. Studentët kanë të drejtë të ankohen lidhur me cilësinë e procesit të mësimdhënies. Statuti përmban dispozita mbi trajtimin e drejtë të ankesave të tilla.</p> <p>6. Rrethanat në bazë të të cilave studentët mund të çregjistrohen për arsye akademike apo disiplinore si dhe procedurat për ankesë përcaktohen më hollësisht në statutin e institucionit.</p> <p>7. Studentët gëzojnë të drejtën për të kundërshtuar një vendim apo një veprim, ose mosveprim të institucionit të arsimit të lartë,</p>	<p>4.1. Guarantee the student freedom, within the law to present new ideas and debatable opinions without risking the loss of the student's place or privileges that can be enjoyed by the institution;</p> <p>4.2. Guarantee the freedom of speech, of organization and of gatherings according to legal provisions;</p> <p>4.3. Protect students from any kind of discrimination;</p> <p>4.4. Provide impartial and objective mechanisms for dealing with disciplinary matters dealing with students;</p> <p>5. Students are entitled to complain regarding to the quality teaching process. The statute contains provisions on fair treatment of such complaints.</p> <p>6. The circumstances on the basis of which students can be deregistered for academic or disciplinary reasons and procedures for complain are defined in detail in the statute of the institution.</p> <p>7. Students enjoy the right to oppose a decision or an action or omission of the higher education institution towards them by</p>	<p>4.1. Garantuju slobodu studenta da, u okviru zakona, predstavi nove ideje i sporne stavove bez rizika gubitka mesta ili privilegija studenta koje može uživati od strane institucije;</p> <p>4.2. Garantuju slobodu govora, organizacije i okupljanja u skladu sa zakonskim odredbama;</p> <p>4.3. Zaštiti studenata od bilo koje vrste diskriminacije;</p> <p>4.4. Obezbede nepristrasne i objektivne mehanizme za tretiranje disciplinskih pitanja koja se odnose na studente;</p> <p>5. Studenti imaju pravo da se žale u vezi kvaliteta procesa nastave. Statut sadrži odredbe o pravednom tretiranju takvih žalbi.</p> <p>6. Okolnosti na osnovu kojih studenti mogu da se ispišu iz akademskih ili disciplinskih razloga kao i procedure za žalbe su detaljnije određene u statutu institucije.</p> <p>7. Studenti uživaju pravo da se suprotstave odluci ili delovanju, ili ne-delovanju institucije visokog obrazovanja istoj</p>
---	--	--

<p>duke i parashtruar një ankesë fillimisht Ministrisë dhe më pas në gjykatën kompetente.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 34</b> <b>Këshillat e studentëve</b></p> <p>1. Studentët kanë të drejtë të organizohen në këshilla studentore në nivel të njësisë akademike, të institucionit të arsimit të lartë si dhe në nivel kombëtar.</p> <p>2. Këshillat e studentëve janë organizime të pavarura të studentëve nëpër institucionet e arsimit të lartë, të cilat nuk zhvillojnë veprimtari politike dhe ekonomike. Këto këshilla promovojnë pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinojnë përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të institucioneve të arsimit të lartë, në veprimtaritë mësimore-kërkimore dhe të shërbimeve.</p> <p>3. Këshillat e studentëve zgjidhen çdo dy (2) vjet me votat e studentëve dhe mbështeten në legjislacionin në fuqi. Në rastet kur një individ i zgjedhur në këshillat e studentëve përfundon studimet universitare, ai zëvendësohet nga kandidati pasardhës në renditje përnga numri i votave të grumbulluara në zgjedhjet e fundit.</p> <p>4. Këshillat e studentëve nuk mund të organizohen me struktura të tjera politike e</p>	<p>presenting an appeal first to the Minister and then to the competent court.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 34</b> <b>Student Councils</b></p> <p>1. Students are entitled to be organized in councils of students at the level of academic unit, higher education institution, as well as at the national level.</p> <p>2. Student councils are independent organizations of students in higher education institutions, which do not conduct political and economic activities. These councils promote the participation of students and coordinate their representation in steering bodies of higher education institutions, in teaching-research activities and services activities.</p> <p>3. Student councils are elected every two (2) years from the votes of students and rely on the legislation in force. In cases where an elected individual at student councils finishes university studies, he/she is replaced by the successor candidate ranked by the number of votes gathered in the last elections.</p> <p>4. Student councils cannot be organised with other political or non-political structures,</p>	<p>podnoseći žalbu prevashodno ministarstvu a onda i nadležnom sudu.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 34</b> <b>Saveti studenata</b></p> <p>1. Studenti imaju pravo da se organizuju u savete studenata na nivou akademske jedinice, institucije visokog obrazovanja, kao i na nacionalnom nivou.</p> <p>2. Saveti studenata su nezavisne organizacije u institucijama visokog obrazovanja, koji ne obavljaju političke i ekonomske aktivnosti. Ovi saveti promovišu učešće studenata i koordiniraju njihovu zastupljenost u upravnim organima institucija visokog obrazovanja, u nastavno-istraživačkim i uslužnim aktivnostima.</p> <p>3. Saveti studenata se biraju svake dve (2) godine od glasova studenata i oslanjaju se na zakone na snazi. U slučajevima u kojima izabrani pojedinac u savetima studenata završava studije, on/ona se zamenjuje narednim kandidatom u rangiranju po broju glasova prikupljenih na poslednjim izborima.</p> <p>4. Saveti studenata ne mogu da se organizuju sa drugim političkim ili</p>
--	---	--

<p>jopolitike, jashtë institucioneve përkatëse të arsimit të lartë. Modalitetet dhe procedurat për krijimin, organizimin dhe funksionimin e tyre përcaktohen në statutet dhe rregulloret e institucioneve të arsimit të lartë, në përputhje me këtë Ligj.</p> <p>5. Këshillat e studentëve shprehin mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të institucioneve të arsimit të lartë, si për planifikimin strategjik, planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve, përcaktimin e tarifave të shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët, bilancet vjetore paraprake të shpenzimeve ose ndarjen e burimeve financiare, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive, etj.</p> <p>6. Institucionet e arsimit të lartë mbështesin këshillat e studentëve dhe mund të kontribuojnë në financimin e aktiviteteve të tyre.</p>	<p>outside the respective institutions of higher education. Modalities and procedures for their establishment, organization and functioning are determined in the statutes and regulations of higher education institutions, in accordance with this Law.</p> <p>5. Student councils express opinions and proposals in relation to problems of general interest to higher education institutions, as for study plans and programs, regulations for learning activities, the right to study, quality of services, determining tuition fees and other financial contributions to students, preliminary annual balances of expenditures or allocation of financial resources, conducting various cultural activities, arts, sports, etc.</p> <p>6. Higher education institutions support the student councils and can contribute to the financing of their activities.</p>	<p>nepolitičkim strukturama, izvan odgovarajućih institucija visokog obrazovanja. Modaliteti i procedure za njihovo osnivanje, organizaciju i funkcionisanje utvrđuju se statutom i uredbama institucija visokog obrazovanja, u skladu sa ovim Zakonom.</p> <p>5. Saveti studenata izražavaju mišljenja i predloge za sve probleme od opšteg interesa institucija visokog obrazovanja, kao što su strateško planiranje, planovi i program studije, propisi za nastavne aktivnosti, pravo na studiranje, kvalitet usluga, određivanje školarine i drugih finansijskih doprinosa studentima, preliminarni godišnji bilansi rashoda ili raspodeli finansijskih sredstava, obavljanje različitih kulturnih, umetničkih, spotskih aktivnosti itd.</p> <p>6. Institucije visokog obrazovanja podržavaju savete studenata i mogu doprineti finansiranju njihove aktivnosti.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 35</b> <b>Mbështetja financiare për studentët</b></p> <p>1. Ministri mund të nxjerrë akt nënligjor për krijimin e skemës apo skemave për mbështetje financiare të studentëve, bazuar</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 35</b> <b>The financial support for students</b></p> <p>1. The Minister can issue sub-legal act for creation of the scheme or schemes for students' financial support, based on the</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 35</b> <b>Finansijska podrška za studente</b></p> <p>1. Ministar može da izdaje podzakonske akte za stvaranje šeme ili šema za finansijsku podršku studenata, na zasluga ili ekonomskih</p>

<p>në merita ose nevoja ekonomike dhe sociale.</p> <p>2. Skema të tilla të mbështetjes financiare për studentët mund të përfshijnë dispozita që ndihmojnë studentët në pagesat për shkollim dhe në pagesa të tjera të institucioni publik dhe sipas vlerësimit të Ministrit të institucioni privat i arsimit të lartë.</p> <p>3. Institucionet publike të arsimit të lartë mund të krijojnë skema për mbështetje financiare për studentët, me fonde që nuk ndahen nga burime publike.</p> <p>4. Ministri ndërmerri veprime që konsideron se janë të dobishme dhe të nevojshme për të garantuar që studentët e regjistruar në cilindo institucion të kenë mundësi dhe qasje të barabartë për të aplikuar në skemën apo skemat ekzistuese të mbështetjes financiare për studentët, që janë në përputhje me këtë nen.</p> <p>5. Rregullat e përcaktuara nga një institucion publik i arsimit të lartë mund të përcaktojnë rrethanat, në bazë të të cilave studentëve që paguajnë shkollimin dhe që arrijnë rezultate të shkëlqyeshme në mësim, mund t'u ndahet një vend studimi i financuar me fonde publike në vitin e dytë apo në vitin vijues të studimit.</p>	<p>mertis or economic and social needs.</p> <p>2. Such schemes of financial support for students can include the provision in order to help students in payments and education and other payments at the public institution, and according to the Minister's assessment at the private higher education institution.</p> <p>3. Public institutions of higher education can create schemes for student financial support, with funds that are not allocated by public funds.</p> <p>4. The Minister takes actions that it considers useful and necessary to ensure that students enrolled in any institution to have equal opportunity and access to apply in the scheme or existing schemes of the financial support for students, which are in accordance with this article.</p> <p>5. The defined rules by a public higher education institution can define circumstances, based on which students paying education and which achieve excellent results in learning, can be given a study place financed with public funds in the second or in the subsequent study year.</p>	<p>i društvenih potreba.</p> <p>2. Takve šeme finansijske podrške za studente mogu da obuhvataju odredbu za pomaganje studentima u plaćanju školarina i drugih plaćanja u javnim institucijama i prema proceni ministra, kod privatne institucije visokog obrazovanja.</p> <p>3. Javne institucije visokog obrazovanja mogu da stvore šeme za finansijsku podršku za studente, sa sredstvima koja se ne odvajaju iz javnih fondova.</p> <p>4. Ministar preduzima radnje koje smatra da su korisne i potrebne za garantovanje da upisani studenti u bilo kojoj instituciji imaju jednake mogućnosti i pristup da se prijave za šemu ili postojeće šeme finansijske podrške za studente, koje su u skladu sa ovim članom.</p> <p>5. Definisana pravila od strane institucija visokog obrazovanja mogu definisati okolnosti na osnovu kojih studentima koji plaćaju školarinu i koji postignu odlične rezultate u učenju, može im se dati mesto u studijama koje se finansira iz javnih sredstava u drugoj ili u narednoj godini studija.</p>
--	---	--



<p>6. Në bashkëpunim me ministrin, institucionet publike të arsimit të lartë ofrojnë mbështetje me bursa studimi për studentët e shkëlqyer, studentët në programet e studimit në fusha prioritare dhe studentët nga shtresa sociale në nevojë.</p> <p>7. Të gjitha organizatat e financuara me fonde publike që u sigurojnë studentëve strehim, ushqim, ndihmë mjekësore dhe sociale, u nënshtrohen dispozitave të këtij Ligji. Ministri mund t'i udhëzojë këto organizata lidhur me detyrimet, vetëqeverisjen dhe tarifat.</p> <p>8. Ministria mbështetë dhe financon funksionimin e Qendrave të Studentëve të cilat ofrojnë banim, ushqim dhe shërbime tjera për studentët. Funksionimi dhe forma e administrimit të Qendrave të Studentëve rregullohet me akt nënligjor të nxjerrë nga ministri.</p> <p>9. Ministria mbështet Unionin e Studentëve të Republikës së Kosovës (USK). USK është organizatë studentore e përfaqësimit të të gjithë studentëve të Kosovës. Struktura dhe funksionimi i USK, përcaktohet me statut të USK dhe legjislacionit në fuqi.</p>	<p>6. In cooperation with the Minister, public institutions of higher education provide support with study scholarships for excellent students, students in study programs in priority fields and students from social strata in need.</p> <p>7. All organizations financed with public funds that provide shelter, food, medical and social assistance to students, are subject of provisions of this Law. The Minister can instruct these organizations regarding the obligations, self-governance and fees.</p> <p>8. The Ministry supports and finances the functioning of Student Centres which provide housing, food, and other services for students. The functioning and manner of administration of the Student Centres is regulated by sub-legal act issued by the Minister.</p> <p>9. The Ministry supports the Union of Students of the Republic of Kosova (USK). USK is a student organization representing all students in Kosova. The structure and functioning of the USK is defined by the USK statute and legislation in force.</p>	<p>6. U saradnji sa ministarstvom, javne institucije visokog obrazovanja pružaju podršku sa studijskim stipendijama za odlične studente, studente u studijskim programima u prioritnim oblastima i studente iz društvenih slojeva u potrebi.</p> <p>7. Sve organizacije koje su finansirane javnim fondovima, koje obezbeđuju studentima smeštaj, hranu, medicinsku i socijalnu pomoć, su sastavni deo institucije visokog obrazovanja i podležu odredbama ovog Zakona. Ministar može da uputi ove organizacije u vezi sa obavezama, samoupravom i naknadama.</p> <p>8. Ministarstvo podržava i finansira funkcionisanje Studentskih centara koji obezbeđuju smeštaj, hranu i druge usluge za studente. Funkcionisanje i način upravljanja Studentskih centara reguliše se podzakonskim aktima izdatim od strane ministra.</p> <p>9. Ministarstvo podržava Uniju studenata Republike Kosova (USK). USK je studentska organizacija koja predstavlja sve studente sa Kosova. Struktura i funkcionisanje USK, utvrđena su statutom USK i zakonodavstva na snazi.</p>
--	---	---

<p style="text-align: center;"><b>Neni 36</b> <b>Karta e studentit</b></p> <p>1. Studentët e institucioneve të arsimit të lartë pajisen me kartën e studentit. Me anë të saj studentët përfitojnë lehtësira dhe shërbime me çmime të reduktuara në shërbimet publike, sipas përcaktimeve të bëra me vendim të Qeverisë.</p> <p>2. Ministria me akt nënligjor përcakton kriteret dhe procedurat për përgatitjen dhe lëshimin e kartës së studentit.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 36</b> <b>Student card</b></p> <p>1. Students in higher education institutions are equipped with student card. Whereby students benefit facilities and reduced price services in public services, according to the definitions made with the Government's decision.</p> <p>2. The Ministry determines criteria and procedures for preparation and issuance of student card by sub-legal act.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 36</b> <b>Studentska kartica</b></p> <p>1. Studenti u institucijama visokog obrazovanja dobijaju studentsku karticu, pri čemu studenti imaju koristi u objektima i smanjenim cenama usluga u javnim službama, u skladu sa specifikacijama u odluci izdate od strane Vlade.</p> <p>2. Ministarstvo podzakonskim aktom utvrđuje kriterijume i procedure za pripremanje i izdavanje studentske kartice.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 37</b> <b>Baza e të dhënave të studentëve në institucionet e arsimit të lartë</b></p> <p>1. Institucionet e arsimit të lartë ruajnë të dhënat personale të studentëve.</p> <p>2. Të gjitha proceset e ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave personale të studentëve nga institucionet e arsimit të lartë, kryhen bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.</p> <p>3. Ministria mbledh dhe përpunon të dhënat nga institucionet e arsimit të lartë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 37</b> <b>The students database in higher education institutions</b></p> <p>1. Higher education institutions preserve students' personal data.</p> <p>2. All preserving processes and students' personal data processing by higher education institutions are conducted based on the principle of confidentiality and in accordance with the legislation in force law on personal data protection.</p> <p>3. The Ministry collects and processes data from higher education institutions in accordance with the legislation in force law on personal data protection.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 37</b> <b>Baza podataka studenata u institucijama visokog obrazovanja</b></p> <p>1. Institucije visokog obrazovanja čuvaju lične podatke studenata.</p> <p>2. Svi procesi skladištenja i obrade ličnih podataka studenata od strane institucija visokog obrazovanja se ostvaruju na osnovu principa poverljivosti i u skladu sa važećim zakonom o zaštiti ličnih podataka.</p> <p>3. Ministarstvo prikuplja i obrađuje podatke iz institucija visokog obrazovanja u skladu sa važećim zakonom o zaštiti ličnih podataka.</p>

<p>4. Ministria do të caktojë treguesit për raportim të të dhënave me akt nënligjor dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.</p> <p><b>KAPITULLI XI: FINANCIMI, RAPORTIMI DHE LLOGARIDHËNIA E INSTITUCIONEVE PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 38 Autonomia financiare e institucioneve publike të arsimit të lartë</b></p> <p>1. Institucionet publike të arsimit të lartë funksionojnë sipas parimit të autonomisë financiare.</p> <p>2. Institucioni publik i arsimit të lartë harton një plan buxhetor afatmesëm, i cili është pjesë e planit strategjik të zhvillimit të institucionit. Ky plan plotësohet çdo vit.</p> <p>3. Përdorimi i të ardhurave nga fondet publike për institucionet e arsimit të lartë bëhet në përputhje me kushtet dhe qëllimet e buxhetit të akorduar dhe në përputhje me planin strategjik të institucionit të rënë dakord nga Ministria.</p>	<p>4. The Ministry will assign indicators for data reporting with sub-legal act and in accordance with the legislation in force law on personal data protection.</p> <p><b>CHAPTER XI: FINANCING, REPORTING AND ACCOUNTABILITY OF PUBLIC HIGHER EDUCATION INSTITUTIONS</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 38 Financial autonomy of public higher education institutions</b></p> <p>1. The public higher education institutions function according to the principle of financial autonomy.</p> <p>2. The public higher education institution drafts medium-term budgetary plan, which is part of the strategic plan for the development of the institution. This plan is updated annually.</p> <p>3. The use of incomes from public funds for higher education institutions is made in accordance with the terms and objectives of the budget allocated and in compliance with the institution's strategic plan agreed by the Ministry.</p>	<p>4. Ministarstvo će odrediti pokazatelje za izveštavanje podataka sa podzakonskim aktom i u skladu sa važećim zakonom o zaštiti ličnih podataka.</p> <p><b>POGLAVLJE XI: FINANSIRANJE, IZVJEŠTAVANJE I ODGOVORNOST JAVNIH INSTITUCIJA VISOKOG OBRAZOVANJA</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 38 Finansijska autonomija javnih institucija visokog obrazovanja</b></p> <p>1. Javne institucije visokog obrazovanja funkcionišu po principu finansijske autonomije.</p> <p>2. Javna institucija visokog obrazovanja izrađuje srednjoročni budžetski plan, koji je deo strateškog plana za razvoj institucije. Ovaj plan se ažurira svake godine.</p> <p>3. Upotreba prihoda iz javnih fondova za institucije visokog obrazovanja obavlja se u skladu sa uslovima i ciljevima budžeta i u skladu sa strateškim planom institucije koja je u saglasnosti sa ministarstvom.</p>
---	---	--

<p>4. Institucionet publike të arsimit të lartë gëzojnë të drejtën të lidhin kontrata për çfarëdo qëllimi që lidhet me arsimin e lartë dhe në rastet kur kjo është pjesë e planit strategjik të zhvillimit të tyre, edhe në lidhje me kërkimet shkencore. Institucioni mund t'i investojnë fondet, duke përfshirë ato publike, në cilëndo ndërmarrje me qëllime të arsimit apo të kërkimit shkencor me kusht që:</p> <p>4.1. Ato kontrata të ndërlidhen me projekte që përkrahin planin strategjik të zhvillimit të institucionit;</p> <p>4.2. Asnjë kontratë të mos imponojë ndonjë detyrim financiar ndaj pasurisë dhe pronës publike pa aprovimin e ministrit sipas normativës ligjore dhe</p> <p>4.3. Fondet publike të mos përfshihen në rreziqe të mundshme të cilat rregullohen me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>4. Public higher education institutions enjoy the right to sign contracts for any purpose regarding to higher education and in cases when this is part of their strategy development plan, also regarding to scientific research. The institution may invest funds, including public ones; in any enterprise for the purpose of education or scientific-research, on condition that:</p> <p>4.1. Those contracts to be interrelated with projects that support the strategic development plan of the institution;</p> <p>4.2. No contract to impose any financial obligation against property and public property without the approval of the Minister according to the legal normative and</p> <p>4.3. Public funds not to be involved in possible dangers, which are regulated with legislation in force</p>	<p>4. Javne institucije visokog obrazovanja uživaju pravo da potpišu ugovore za bilo koju svrhu u vezi sa visokim obrazovanjem i u slučajevima kada je to deo njihove plana razvoja strategije, takođe i u vezi sa naučnim istraživanjima. Institucija može uložiti sredstva, uključujući i javne fondove, u svakom poduhvatu s ciljem obrazovanja ili istraživanja, pod uslovom da:</p> <p>4.1. Ovi ugovori su međusobno povezani sa projektima koji podržavaju strateški plan razvoja institucije;</p> <p>4.2. Nijedan ugovor da ne nameće finansijsku obavezu na imovinu i društvene imovine bez odobrenje ministra u prema zakonskim normativima i</p> <p>4.3. Javni fondovi da nesmeju biti uključeni u moguće rizike koje se uređuju zakonodavstvom na snazi.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 39</b> <b>Burimet e financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë</b></p> <p>1. Institucionet publike të arsimit të lartë financohen nga:</p> <p>1.1. Buxheti i Konsoliduar i Kosovës;</p> <p>1.2. Pagesat e studentëve për arsimim;</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 39</b> <b>Funding sources of public higher education institutions</b></p> <p>1. Public institutions of higher education are financed by:</p> <p>1.1. Kosova Consolidated Budget;</p> <p>1.2. Students payments for education;</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 39</b> <b>Izvori prihoda javnih institucija visokog obrazovanja</b></p> <p>1. Javne institucije visokog obrazovanja se finansiraju iz:</p> <p>1.1. Konsolidovani budžeta Kosova;</p> <p>1.2. Studentske uplate za obrazovanje;</p>

<p>1.3. Të ardhurat për shërbimet e kryera;</p> <p>1.4. Të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta;</p> <p>1.5. Donacione dhe ndihmesa të tjera;</p> <p>1.6. Veprimtari kërkimore-shkencore;</p> <p>1.7. Kontratat me organe të jashtme, ndërkombëtare, publike apo private në fushën e mësimdhënies, të kërkimeve shkencore apo të këshillimit;</p> <p>1.8. Burime të tjera të ligjshme financimi.</p> <p>2. Institucionet publike të arsimit të lartë rregullojnë në aktet e tyre të brendshme, mënyrën e përdorimit të fondeve të krijuara nga të ardhurat e përcaktuara në këtë nen, me përjashtim të të ardhurave nga Buxheti i Kosovës.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 40</b> <b>Alokimi i fondeve publike për institucionet e arsimit të lartë</b></p> <p>1. Qeveria ofron fonde publike për mbështetjen e institucioneve publike të arsimit të lartë, përfshirë programet e tyre për hulumtime shkencore, aktivitetet për</p>	<p>1.3. Incomes for services performed;</p> <p>1.4. Incomes generated from agreements with third parties;</p> <p>1.5. Donations and other contributions;</p> <p>1.6. Scientific-Research activities;</p> <p>1.7. Contracts with external bodies, international, public or private in the area of teaching, scientific-research or of counselling;</p> <p>1.8. Other legal funding sources.</p> <p>2. Public higher education institutions of regulate their internal acts, the way of using the funds generated by the incomes specified in this article, with the exception of incomes from the Kosova Consolidated Budget.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 40</b> <b>Allocation of public funds to higher education institutions</b></p> <p>1. The government makes available public funds to support public higher education institutions, including their study programs, scientific research, continuing education and</p>	<p>1.3. Prihodi za obavljene usluge;</p> <p>1.4. Prihodi ostvareni iz odnosa sa trećim stranama;</p> <p>1.5. Donacija i druga pomoć;</p> <p>1.6. Naučno – istraživačka delatnost;</p> <p>1.7. Ugovori sa spoljašnjim organima, međunarodnim, javnim ili privatnim u oblasti nastave, naučnog istraživanja ili savetovanja;</p> <p>1.8. Drugi zakonski izvori finansiranja.</p> <p>2. Javne institucije visokog obrazovanja regulišu svojim unutrašnjim aktima, način korišćenja sredstava ostvarenih od prihoda navedenih u ovom članku, sa izuzetkom prihoda iz konsolidovanog budžeta Kosova.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 40</b> <b>Raspodela javnih sredstava za institucije visokog obrazovanja</b></p> <p>1. Vlada dodeljuje javna sredstva za podršku javnih institucija visokog obrazovanja, uključujući njihove studijske programe, naučno istraživanje, kontinuirano</p>
---	---	--

<p>mësim të vazhdueshëm dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës, si dhe për infrastrukturë, menaxhment dhe studentët e tyre, në pajtim me përparësitë e zhvillimit dhe interesat strategjikë të vendit.</p> <p>2. Ministri mund të inicoj sigurimin e fondeve publike për institucionet private të arsimit të lartë të licencuar dhe të akredituar në mbështetje të objektivave shtetërore. Një institucion privat i cili pranon fonde publike, i nënshtrohet përgjegjësisë dhe kërkesave të auditimit njëjtë si edhe institucionet publike, siç është përcaktuar në këtë Ligj.</p> <p>3. Në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe institucionet publike të arsimit, ministri me akt nënligjor përcakton metodologjinë që do të përdoret për caktimin e fondeve për mësimdhënie dhe kërkime shkencore me interes publik, së bashku me shtesa të tjera ose koncesione, të cilat mund të miratohen nga Qeveria.</p> <p>4. Caktimi i fondeve për mësimdhënie e specifikon numrin e studentëve të institucioneve publike të arsimit të lartë që do të arsimohen me shpenzimet publike në disiplina e fusha të caktuara studimi. Ky numër duhet të jetë në përputhje me numrin maksimal të përcaktuar në licencën aktuale të institucionit dhe programeve të</p>	<p>Lifelong Learning activities, as well as for infrastructure, management and their students, in compliance with development advantages and strategic interests of the country.</p> <p>2. The Minister can initiate public funds for licensed and accredited private providers of higher education in supporting the state objectives. A private provider who accepts public funds is subject to responsibility and requirements of the same audit, like public providers, as determined in this Law.</p> <p>3. In cooperation with the Minister of Finances and public institutions of higher education, the Minister with sub-legal act defines the methodology that is used for assigning the funds on teaching and scientific researches with public interest, together with other supplements or concessions, which can be adopted by the government.</p> <p>4. The allocation of funds for teaching specifies the number of students of public higher education institutions to be educated at public expense in certain disciplines or fields of study. This number should be in compliance with the maximum number which is defined in the current license of the institution and accredited programs approved</p>	<p>obrazovanje i aktivnosti doživotnog učenja, kao i infrastrukturu i upravljanje i svoje studente, u skladu sa razvojnim prednostima i strateškim interesima zemlje.</p> <p>2. Ministar može da inicira obezbeđivanje javnih sredstva za licencirane i akreditovane privatne institucije visokog obrazovanja u pružanju podrške državnih ciljevima. Privatnih institucija koje dobijaju javna sredstva i podležu odgovornosti i zahtevima revizije, isto kao i javne institucije, kao što je utvrđeno ovim zakonom.</p> <p>3. U saradnji sa ministrom finansija i javnim institucijama visokog obrazovanja, ministar podzakonskim aktom utvrđuje metodologiju koja se koristi za dodelu sredstava na nastavi i naučna istraživanja od javnog interesa, zajedno sa ostalim dodacima ili koncesijama, koje mogu biti usvojene od strane vlade.</p> <p>4. Raspodela sredstava za nastavu određuje broj studenata javnih institucija visokog obrazovanja za obrazovanje u državnom trošku u pojedinim disciplinama ili oblastima studija. Ovaj broj treba da bude u skladu sa maksimalnim brojem koji je definisan aktuelnom licencom institucije akreditovane od strane KAA.</p>
--	---	--

<p>akredituara të aprovuara nga AKA.</p> <p>5. Ministri cakton fondet për institucionet publike të arsimit të lartë, duke marrë parasysh objektivat e specifikuara në planin strategjik të institucionit dhe çfarëdo vërejtjesh apo rekomandimesh nga AKA lidhur me cilësinë e mësimdhënies të këtyre institucioneve ose të programeve të veçanta.</p> <p>6. Ministri bazuar në performancën e fundit të institucionit mund të caktojë një zë buxhetor për një cikël të financimit pesëvjeçar, si pjesë e një marrëveshje të performancës dhe planin strategjik të institucionit, i cili po ashtu do të zgjasë pesë (5) vite dhe do të publikohet nga Ministria.</p> <p>7. Fondet caktohen çdo vit si një shumë që i jepet institucionit gjatë vitit financiar në intervale kohore të përcaktuara në marrëveshjen e ekzekutimit nga ministri i Financave, brenda planit strategjik dhe kufijve të caktuar në licencë dhe sipas çfarëdo kushtesh të ministrit për të trajtuar fondet.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 41</b> <b>Kushtet e shfrytëzimit të fondeve publike</b></p> <p>1. Në caktimin e fondeve për mësimdhënie dhe kërkime shkencore me interes të</p>	<p>by KAA.</p> <p>5. The Minister assigns funds for public higher education institutions, by taking into account the specified objectives in the strategic plan of the institution and any remarks or recommendations from KAA related to the quality of teaching in these institutions or specific programs.</p> <p>6. The Minister based on last performance of the institution can set a budgetary line for a funding cycle of five years, as part of a performance agreement and the strategic plan of the institution, which will also last for five (5) years and will be published by the Ministry.</p> <p>7. The funds are allocated every year as an amount that is given to the institution during the financial year at the time intervals specified in the execution agreement by the Minister of Finance, within the strategic plan and boundaries set in the license and under any conditions of the Minister for dealing with funds.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 41</b> <b>Terms on the use of public funds</b></p> <p>1. In setting funds for teaching and research in the public interest, the minister may set</p>	<p>5. Ministar dodeljuje fond javnim institucijama visokog obrazovanja, uzimajući u obzir ciljeve navedene u strateškom planu institucije i bilo kakve primedbe i preporuke KAA u vezi sa kvalitetom nastave u ovim institucijama ili specifičnim programima.</p> <p>6. Ministar, na osnovu poslednje performanse institucije može da odredi budžetsku liniju za finansiranje petogodišnjeg ciklusa, kao deo sporazuma o performansi i strateškog plana institucije koje će takođe trajati pet (5) godina i biće objavljeni ministarstvo.</p> <p>7. Sredstva se dodeljuju svake godine kao iznos koji se daje instituciji tokom finansijske godine u vremenskim intervalima utvrđenim u sporazum o izvršavanju od strane ministar finansija, u okviru strateškog plana i ograničenjima utvrđenim u licenci i prema bilo kojim uslovima ministra da tretira sredstva.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 41</b> <b>Uslovi za korišćenje javnih sredstava</b></p> <p>1. U dodeljivanju sredstava za nastavu i istraživanja od opšteg interesa, ministar može</p>
---	--	--

<p>përgjithshëm, ministri mund t`u caktojë kushte institucioneve të arsimit të lartë.</p> <p>2. Kushtet që caktohen sipas këtij neni janë në përputhje me statutin e institucionit në fjalë dhe kanë të bëjnë me:</p> <p>2.1. Kontrollin financiar dhe auditimin;</p> <p>2.2. Blerjen, shfrytëzimin dhe pronësinë me truall, objekte dhe pajisje;</p> <p>2.3. Nivelin dhe aplikimin e pagesave për shkollim dhe të pagesave të tjera të studentëve;</p> <p>2.4. Ndryshimin e destinimit ose transferimin e fondeve të caktuara për mësimdhënie nga një fushë mësimore në tjetrën;</p> <p>2.5. Përputhshmërinë e zbatimit të kodeve të mirësjelljes.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 42</b> <b>Pagesat e shkollimit dhe tarifat tjera</b></p> <p>1. Ministri përcakton me akt nënligjor, i cili rishqyrtohet çdo vit, pagesën maksimale të shkollimit që duhet paguar nga studentët që pranohen në institucionin publik të arsimit të</p>	<p>conditions to higher education institutions.</p> <p>2. The conditions that are set according to this article are in compliance with the mentioned institution's statute and they deal with:</p> <p>2.1. Financial check and audit;</p> <p>2.2. Purchase, use and ownership of land, buildings and equipment;</p> <p>2.3. Level and application of payments for education and other student payments;</p> <p>2.4. Change of destination or transfer of funds set for teaching by one teaching field to another.</p> <p>2.5. Conformity of the implementation of codes of conduct</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 42</b> <b>Tuition fees and other fees</b></p> <p>1. The Minister shall determine with sub-legal act, which is reviewed every year, the maximum tuition that has to be paid by students admitted to a public institution of</p>	<p>da odredi uslove institucijama visokog obrazovanja.</p> <p>2. Uslovi koji se postavljaju prema ovom članu su u skladu sa statutom pomenute institucije i odnose se na:</p> <p>2.1. Finansijsku kontrolu i reviziju;</p> <p>2.2. Kupovinu, korišćenje i vlasništvo nad zemljištem, objektima i opremom;</p> <p>2.3. Nivo i primenjivanje plaćanja školarina i ostalih studentskih taksi;</p> <p>2.4. Promenu namene ili transfer sredstava određenih za nastavu iz jedne nastavne oblasti u drugu.</p> <p>2.5. Usklađenost sprovođenja kodeksa ponašanja.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 42</b> <b>Uplata školarina i ostale naknade</b></p> <p>1. Ministar određuje podzakonski akt, koji se razmatra svake godine, određuje maksimalnu školarinu koja se treba platiti od strane studenata koji su primljeni u javnoj</p>
---	---	---



<p>lartë të financuar nga Qeveria.</p> <p>2. Institucionet e arsimit të lartë përcaktojnë koston e studimeve për secilën fushë të studimeve.</p> <p>3. Pagesat për shkollim mund të përcaktohen në nivele të ndryshme:</p> <p>3.1. Varësisht nëse studenti banon në Kosovë apo diku tjetër;</p> <p>3.2. Për programet e ndryshme sipas kostove që kanë.</p> <p>4. Tarifat e institucioneve publike të arsimit të lartë të tilla si: tarifa për shqyrtimin e aplikacioneve, për regjistrim, për përsëritjen e provimeve dhe për diplomim, duhet të miratohen nga ministri.</p> <p>5. Institucionet publike të arsimit të lartë mund të kërkojnë mbulimin e plotë të koston ekonomike për dhënien e shërbimeve duke përfshirë fotokopjimin, materiale speciale dhe shërbime të tjera ndihmëse.</p>	<p>higher education that is funded by the Government.</p> <p>2. Higher education institutions determine the cost of studies for each field of study</p> <p>3. Tuition fees can be determined at different levels.</p> <p>3.1. Depending whether the student lives in Kosovo or somewhere else;</p> <p>3.2. For various programs according to the costs they have.</p> <p>4. Public higher education institutions their fees, as fees for reviewing applications, for registration, repetition of exams and for graduation, and these fees shall be approved by the Minister.</p> <p>5. Public institutions of higher education may require full coverage of the economic cost for the provision of services including photocopying, special materials and other ancillary services.</p>	<p>instituciji visokog obrazovanja, finansirane od strane Vlade.</p> <p>2. Institucije visokog obrazovanja utvrđuju visinu iznosa za studije za svaku oblast.</p> <p>3. Plaćanje za školarinu se može odrediti na raznim nivoima.</p> <p>3.1. U zavisnosti od toga ukoliko student stanuje na Kosovu ili negde drugde;</p> <p>3.2. Za razne programe na osnovu troškova.</p> <p>4. Javne institucije visokog obrazovanja postavljaju tarife, kao što je tarifa za razmatranje aplikacija, za upis, za ponavljanje ispita i za diplomiranje i ove tarife se trebaju usvojiti od strane ministra.</p> <p>5. Javne institucije visokog obrazovanja mogu da zahtevaju potpunu pokrivenost ekonomskih troškova za pružanje usluga uključujući fotokopiranje, specijalne materijale i druge pomoćne usluge.</p>
--	---	---

<p align="center"><b>Neni 43</b> <b>Veprimtaria komerciale e institucioneve publike</b></p>	<p align="center"><b>Article 43</b> <b>Commercial activities of public institutions</b></p>	<p align="center"><b>Član 43</b> <b>Komercijalna delatnost javnih institucija</b></p>
<p>1. Institucioni publik i arsimit të lartë gëzon të drejtën që në përputhje me dispozitat e këtij Ligji dhe legjislacionit në fuqi, me licencën, me statutin dhe me planin strategjik të zhvillimit, të marrë masa për të nxitur e shfrytëzuar veprimtarinë e tij arsimore dhe kërkimore për qëllime komerciale në favor të institucionit.</p> <p>2. Kur veprimtari të tilla komerciale përfshijnë ose potencialisht mund të përfshijnë shfrytëzimin e ndonjë të drejte të rëndësishme të pronës intelektuale lidhur me vepra letrare, artistike dhe shkencore, zbulime shkencore, projekte, shpikje, materiale, mallra ose shërbime të siguruara plotësisht apo pjesërisht duke përdorur fonde publike, institucioni i arsimit të lartë përcakton se cila është e drejta e rëndësishme e një prone intelektuale me anë të një rregulloreje, ku merret parasysh këshilla e dhënë nga Zyra për të drejtat e pronës intelektuale ose nga ministria kompetente sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p>3. Tatimimi i aktivitetit komercial të një institucioni publik të arsimit të lartë është në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>1. The public institution of higher education enjoys the right that in accordance with this Law and legislation in force, with the license, with the statute and with its strategic development plan, to take measures to stimulate and use its educational activity and scientific research for commercial purposes at the institution's favor.</p> <p>2. When such commercial activities include or potentially can include use of any important right of the intellectual property related to literary, artistic and scientific works, scientific discoveries, designs, inventions, materials, goods or services provided wholly or partly by public funds, the higher education institution defines what is the important right of an intellectual property according to this regulation, when the given advice is taken into account by the office on the right of intellectual property or from the competent ministry according to the legislation in force.</p> <p>3. Taxation of commercial activity of a public higher education institution is in accordance with legislation in force.</p>	<p>1. Javna institucija visokog obrazovanja uživa pravo da, u skladu sa odredbama ovog zakona i važećih zakona, sa licencom, statutom i strateškim planom razvoja, uzima mere radi podsticanja i korišćenja njene obrazovne delatnosti i naučnog istraživanja za komercijalne svrhe u korist institucije.</p> <p>2. Kada ovakve komercijalne delatnosti obuhvataju ili potencijalno mogu da obuhvataju korišćenje nekog značajnog prava intelektualne svojine u vezi sa književnim, umetničkim i naučnim delima, naučnim otkrićima, projektima, pronalascima, materijalima, robama ili uslugama osiguranih u celini ili delimično koristeći javna sredstva, institucija visokog obrazovanja određuje koje je značajno pravo za jednu intelektualnu svojину prema ovoj uredbi, gde se uzima u obzir savet koji je dat od strane Kancelarije za pravo intelektualne svojine ili od strane nadležnog ministarstva prema važećem zakonodavstvu.</p> <p>3. Oporezivanje komercijalne aktivnosti jedne javne institucije visokog obrazovanja je u skladu sa važećim zakonima.</p>

<p style="text-align: center;"><b>Neni 44</b> <b>Kontrolli financiar</b></p> <p>1. Statuti i çdo institucioni publik të arsimit të lartë përfshin dispozita për kryerjen e një kontrolli financiar të efektshëm dhe të pavarur, të brendshëm dhe të jashtëm.</p> <p>2. Një kopje e çdo raporti të hartuar nga auditori i jashtëm apo i brendshëm i dërgohet ministrit, i/e cili/a mund të kërkoj shpjegime nga Bordi i institucionit publik të arsimit të lartë, nëse e gjykon të nevojshme një gjë të tillë.</p> <p>3. Ministri mund të caktojë një auditor të pavarur për të hetuar çështjet financiare të çdo institucioni publik të arsimit të lartë dhe Bordi i këtij institucioni duhet të sigurojë bashkëpunimin me auditorin.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 44</b> <b>Financial control</b></p> <p>1. The statute of each public higher education institution includes provision for conducting effective, independent, internal and external financial control.</p> <p>2. A copy of each compiled report by the external and internal audit is sent to Minister, which can require explanations from the public institution of higher education, if such a thing seems necessary.</p> <p>3. The Minister can assign an independent audit to investigate on financial issues of each public institution of higher education and the Board of this institution should ensure cooperation with the auditor.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 44</b> <b>Finansijska kontrola</b></p> <p>1. Statut svake javne institucije visokog obrazovanja obuhvata odredbe za obavljanje jedne efikasne i nezavisne finansijske kontrole, interne ili eksterne.</p> <p>2. Jedan primerak svakog izveštaja izrađenog od strane internog ili eksternog revizora se dostavlja ministru, koji može da zahteva objašnjenja od strane javne institucije visokog obrazovanja, ukoliko se takva stvar smatra potrebnim.</p> <p>3. Ministar može da odredi jednog nezavisnog revizora radi ispitivanja finansijskih pitanja svake javne institucije visokog obrazovanja i Odbor ove institucije treba da obezbedi saradnju sa revizorem.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 45</b> <b>Llogaridhënia e institucioneve publike</b></p> <p>1. Këshilli drejtues i një institucioni publik të arsimit të lartë është përgjegjës kolektivisht para ministrit për përdorimin e duhur dhe të efektshëm të fondeve që i janë caktuar institucionit nga Qeveria ose nga burime të tjera publike.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 45</b> <b>Accountability of the public institutions</b></p> <p>1. Steering Council of a public institution of higher education is collectively responsible before the Minister, for proper and effective use of funds that are assigned to the institution by the Government or by other public resources.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 45</b> <b>Odgovornost javne institucije</b></p> <p>1. Upravni odbor jedne javne institucije visokog obrazovanja je kolektivno odgovoran ispred ministra za pravilnu i efikasnu upotrebu sredstava koja su određena instituciji od strane Vlade ili drugih javnih izvora.</p>

<p>2. Institucionet publike të arsimit të lartë, për çdo vit akademik, i dorëzojnë ministrit raportet vjetore për veprimtarinë e kryer, për performancën vjetore, gjendjen financiare të institucionit, parashikimin mbi angazhimin e personelit akademik, përputhshmërinë me kodin e mirësjelljes si dhe elementë të tjerë të përcaktuar me udhëzim të ministrit. Koha e këtij raportimi është jo më vonë se më 31 mars të vitit pasues.</p> <p>3. Raporti i performancës do të krahasojë rezultatet e arritura me planin strategjik të zhvillimit dhe marrëveshjet për performancë për vitin në shqyrtim.</p> <p>4. Rektori i një institucioni publik të arsimit të lartë do t'ia tërheqë vërejtjen Këshillit drejtues për çdo veprim apo lëshim të tij, i cili sipas mendimit të rektorit, përbën një shpërdorim të fondeve publike që i janë dhënë institucionit.</p> <p>5. Në rast se Këshilli drejtues nuk vepron për të korrigjuar veprime të tilla jo të duhura apo lëshime, atëherë rektori do t'ia raportoje drejtpërdrejt këto veprime ose lëshime ministrit. Në raste të tilla, pavarësisht nga ndonjë dispozitë e statutit të institucionit që është e kundërt me këtë, Këshilli drejtues apo ndonjë organ tjetër nuk mund të ndër marrë asnjë veprim ndaj rektorit, me</p>	<p>2. For each academic year, public institutions of higher education submit to the Minister annual reports on the activities carried out, for the annual performance, financial condition of the institution, the forecast on the engagement of academic personnel and other elements stipulated in the instruction of the Minister. This report should be submitted no later than the March 31<sup>st</sup> of the subsequent year.</p> <p>3. The performance report will compare the achieved results with the strategic development plan and performance agreements for the year in review.</p> <p>4. The Rector of a public higher education institution will warn the Steering Council for any action or its omission, which according to the Rector's opinion constitutes a misuse of public funds that are given to the institution.</p> <p>5. In the event when the Steering council does not act to correct such inappropriate actions or omissions, the Rector will report directly to the Minister these acts or omissions. In such cases, regardless by any provision of the institution's statute, which is opposite with this, the Steering Council or any other body cannot take any action against the Rector, except in cases when the Minister</p>	<p>2. Za svaku akademsku godinu, javne institucije visokog obrazovanja dostavljaju ministru godišnje izveštaje o sprovedenim aktivnostima, godišnji učinak, finansijsko stanje institucije, predviđanja o angažovanju akademskog osoblja usklađenost sa kodeksom ponašanja kao i drugih elemenata koji su navedeni u uputstvu ministra. Ovaj izveštaj treba dostaviti najkasnije do 31. marta naredne godine.</p> <p>3. Izveštaj učinka će uporediti postignute rezultate sa strateškim planom razvoja i sporazumima o učinku za godinu razmatranja.</p> <p>4. Rektor jedne javne institucije visokog obrazovanja će upozoriti Upravni odbor za svaku radnju ili propust, koji, prema mišljenju Rektora, predstavlja zloupotrebu javnih sredstava koji su dati instituciji.</p> <p>5. U slučaju da Upravni odbor ne deluje radi otklanjanja takvih ne-odgovarajućih radnji ili propusta, onda će rektor direktno izveštavati ministru za takve radnje ili propuste. U takvim slučajevima, bez obzira na neku odredbu statuta institucije koja je u suprotnosti sa time, Upravni odbor ili bilo koji drugi organ ne može da preduzme nikakve radnje prema Rektor, osim u slučaju</p>
--	---	---

<p>përrjashtim të rasteve kur vet ministri e lejon një veprim të tillë.</p> <p>6. Nëse, sipas vlerësimit të ministrit që bazohet në raportet përfundimtare dhe rekomandimet nga Zyra e Auditorit të përgjithshëm, çështjet financiare apo çështjet e tjera të një institucioni kanë qenë ose janë duke u keqadministruar apo dispozitat e statutit nuk janë zbatuar në përputhje me këtë Ligj dhe me statutin, ministri mund të jep udhëzime në lidhje me qeverisjen dhe menaxhimin e institucionit që i sheh të arsyeshme, duke përfshirë, shkarkimin dhe zëvendësimin e përkohshëm të një ose më shumë anëtarëve të Këshillit drejtues.</p> <p><b>KAPITULLI XII: INSTITUCIONET PRIVATE TË ARSIMIT TË LARTË</b></p> <p><b>Neni 46 Organizimi dhe funksionimi</b></p> <p>1. Një institucion privat i arsimit të lartë gëzon lirinë që në statutin e tij apo në dokumente të tjera themeluese të aprovojë çfarëdo modeli të qeverisjes dhe të menaxhimit, me kusht që ky model të ndajë në mënyrë të qartë rolin dhe kompetencat e pronarëve nga çështjet akademike.</p>	<p>itself allows such an action.</p> <p>6. If, as estimated by the Minister which is based on final reports and recommendations from the General Auditor's Office, financial issues or other issues of an institution have been or are being mismanaged or statutory provisions have not been implemented in accordance with this Law and with statute, the Minister can give instructions regarding governance and management of the institution that sees as reasonable, including, discharge and temporary replacement of one or more members of the Steering Council.</p> <p><b>CHAPTER XII: PRIVATE HIGHER EDUCATION INSTITUTIONS</b></p> <p><b>Article 46 Organisation and functioning</b></p> <p>1. A private higher education institution enjoys freedom in its statute or in other founding documents to adopt any governance and management model, on condition that this model clearly separates the role and competencies of owners from academic matters.</p>	<p>kada sam ministar dozvoljava takvu radnju.</p> <p>6. Ukoliko su, prema proceni ministra koja se zasniva na konačnim izveštajima i preporukama iz kancelarije Generalnog revizora, finansijska pitanja ili druga pitanja jedne institucije bile ili se loše upravljaju ili odredbe statuta nisu sprovedene u skladu sa ovim Zakonom ili statutom, ministar može da daje instrukcije u vezi sa upravljanjem i rukovodstvom institucije koje ministar smatra prikladnim, uključivanjem, privremenim razrešenjem ili zamenom jednog ili više članova Upravnog odbora.</p> <p><b>POGLAVLJE XII: PRIVATNE INSTITUCIJE VISOKOG OBRAZOVANJA</b></p> <p><b>Član 46 Organizovanje i funkcionisanje</b></p> <p>1. Jedna privatna institucija visokog obrazovanja uživa slobodu da na njenom statutu ili drugim osnivačkim dokumentima usvoji bilo koji model upravljanja i rukovođenja, pod uslovom da ovaj model na jasan način podeli ulogu i nadležnosti vlasnika od akademskih pitanja.</p>
---	--	---

<p>2. Të gjitha institucionet private të arsimit të lartë duhet të jenë të akredituara nga AKA dhe licencuar nga ministria para fillimit të funksionimit të tyre. Për këtë qëllim ata duhet të plotësojnë të gjitha kërkesat për akreditim dhe licencim siç përcaktohen në këtë ligj si dhe ato specifike si në vijim:</p> <p>2.1. Statutet duhet të:</p> <p>2.1.1. Përcaktojnë strukturën e qeverisjes dhe menaxhimit të institucionit, së bashku me misionin dhe qëllimet e tyre strategjike dhe statutet e tyre të cilat e përcaktojnë nëse ato janë subjekte fitimprurës apo jofitimprurës;</p> <p>2.1.2. Lejojnë pjesëmarrjen e personelit mësimdhënës dhe të studentëve në vendimmarrje lidhur me çështjet akademike;</p> <p>2.1.3. I garantojnë personelit lirinë e organizimit dhe të grumbullimit dhe mbrojtjen e personelit nga çdo lloj diskriminimi;</p> <p>2.1.4. Parashih punësimin, organizimin dhe promovimin e personelit akademik, duke përfshirë edhe dhënien e titujve akademikë</p>	<p>2. All private higher education institutions must be accredited by KAA and licensed by the Ministry before they can start operating. For this purpose, they must meet all general conditions for accreditation and licensing set out in this Law, as well as the following specific ones:</p> <p>2.1. The statutes must:</p> <p>2.1.1. Determine the structure of governance and management of the institution, along with its mission and strategic goals and its status which determine whether they are profitable or non-profitable entities;</p> <p>2.1.2. Allow the participation of teaching staff and students in decision making regarding academic issues;</p> <p>2.1.3. Guarantee to personnel the freedom of organization and gathering and the personnel protection against any kind of discrimination;</p> <p>2.1.4. Foresees employment, organization and promotion of academic staff, including the awarding of academic degrees in</p>	<p>2. Sve privatne obrazovne institucije moraju biti akreditovane od strane KAA i licencirane od strane ministarstva pre nego što one mogu da počnu da rade. U tu svrhu, moraju ispunjavati sve opšte uslove za akreditaciju i licenciranje određene u ovom zakonu, kao i sledeće posebne uslove:</p> <p>2.1. Statuti moraju da:</p> <p>2.1.1. Određuju strukturu upravljanja i rukovođenja institucije, zajedno sa njenom misijom i njenim strateškim ciljevima i njenim statusom kojim se utvrđuje dali je profitabilan ili neprofitabilan subjekat;</p> <p>2.1.2. Dozvoljava učešće nastavnog osoblja i studenata u donošenju odluka u vezi sa akademskim pitanjima;</p> <p>2.1.3. Garantuju osoblju slobodu organizovanja i okupljanje i zaštitu protiv bilo kakve diskriminacije;</p> <p>2.1.4. Predviđa zapošljavanje, organizovanje i promociju akademskog osoblja, uključujući u odnosu na dodelu akademskih titula i priznavanje</p>
--	--	---

<p>konform dispozitave ligjore në fuqi dhe njohjen e kualifikimeve të huaja;</p> <p>2.2. Objektet dhe burimet tjera fizike duhet të jenë të përshtatshme dhe të sigurta për punën arsimore të institucionit, ku institucioni ka të drejtë të plotë ligjore në shfrytëzimin e tyre;</p> <p>2.3. Mësimdhënësit, hulumtuesit dhe personeli ndihmës duhet të jenë të kualifikuar në nivelin e duhur për punën arsimore të institucionit të arsimit të lartë dhe duhet të kontraktohen ligjërisht nga institucioni;</p> <p>2.4. Institucioni duhet të ketë një sistem të mirëfilltë të auditimit financiar;</p> <p>2.5. Institucioni duhet të garantojë interesat e studentëve në rast të mbylljes, falimentimit ose humbjes së akreditimit ose licencës, siç përcaktohet në nenin 49 të këtij Ligji.</p>	<p>accordance with applicable legal provisions and recognition of foreign qualifications;</p> <p>2.2. Facilities and other physical resources must be appropriate and safe to the institution's educational work, and for where the institution has full legal rights to use them;</p> <p>2.3. Teachers, scientific researchers and support staff must be qualified at the appropriate level for the educational work of the higher education institution and must be legally contracted by the institution;</p> <p>2.4. The institution must have a sound financial auditing systems;</p> <p>2.5. The institution must guarantee the students' interest in case of closure, bankruptcy or loss of accreditation or licence, as set out in Article 49 of this Law.</p>	<p>stranih kvalifikacija;</p> <p>2.2. Objekti i drugi fizički resursi moraju da budu odgovarajući i bezbedni za obrazovni rad institucije, a za koje institucija ima puni pravni naziv da ih koristi;</p> <p>2.3. Nastavnici, naučni istraživači i pomoćno osoblje moraju biti kvalifikovani u odgovarajućem nivou za obrazovni rad u instituciji visokog obrazovanja i moraju biti zakonski ugovoreni od strane institucije;</p> <p>2.4. Institucija mora imati jedan zdrav sistem finansijske revizije;</p> <p>2.5. Institucija mora da garantuje interese studenata u slučaju zatvaranja, stečaja ili gubitka akreditacije ili licence, kao što je utvrđeno u članu 49. ovog Zakona.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 47</b> <b>Kualifikimet dhe titujt akademik</b></p> <p>1. Titujt akademik mund të jepen nga një institucion privat i arsimit të lartë në</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 47</b> <b>Qualifications and academic titles</b></p> <p>1. Academic titles may be awarded by a private higher education institution in</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 47</b> <b>Kvalifikacije i akademska zvanja</b></p> <p>1. Akademska zvanja može se dati od strane privatne institucije visokog obrazovanja u</p>

<p>përputhje me kriteret dhe titujt e rregulluar me këtë ligj dhe aktet nënligjore.</p> <p>2. Titujt akademikë që jepen nga institucionet private të arsimit të lartë, mund por nuk janë detyruese për palët e treta.</p> <p>3. Asnjë anëtar i personelit akademik nuk mund të punësohet nga institucioni privat i arsimit të lartë në Kosovë, pa njohjen e mësimit paraprak/barasvlerës formale të diplomave dhe gradave të fituara jashtë Republikës së Kosovës, përveç për realizimin e programeve të studimeve të akredituara nga një autoritet jashtë Kosovës, i njohur nga AKA.</p>	<p>accordance with the criteria and titles regulated by this Law and sub-legal acts.</p> <p>2. Academic titles that are given by private higher education institutions can but are not obligatory for third parties.</p> <p>3. No academic personnel member can be hired by any private institution of higher education in Kosovo, without recognition of prior learning / formal equivalence of diplomas and degrees obtained outside the Republic of Kosovo, except for realization of study programs accredited by an authority outside of Kosovo and recognized by KAA.</p>	<p>skladu sa kriterijume i zvanja uređena ovim zakonom.</p> <p>2. Akademska zvanja dodeljena od strane privatnog institucije visokog obrazovanja nisu obavezujuće za treće strane.</p> <p>3. Nijedno akademsko osoblje ne može biti zaposleno od strane bilo koje privatne institucije visokog obrazovanja na Kosovu bez prethodnog formalnog priznanja/ekvivalencije titula dobijenih van Republike Kosova, osim za realizaciju programa akreditovanih studija od strane jednog autoriteta izvan Kosova, koji je priznat od strane KAA-a.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 48 Financimi</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 48 Funding</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 48 Financiranje</b></p>
<p>1. Institucionet private të arsimit të lartë janë përgjegjëse për financimin e tyre dhe duhet të ofrojnë dëshmi për qëndrueshmërinë e tyre financiare para se të mund të licencohen.</p> <p>2. Një institucion privat i arsimit të lartë, i akredituar dhe licencuar, mund të marrë fonde nga Ministria për aktivitete të caktuara. Ata gjithashtu mund të marrin pjesë në thirrjet për propozime në arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor të shpallura nga</p>	<p>1. Private higher education institutions are responsible for their own funding and must provide evidence of their financial stability before they are licensed.</p> <p>2. An accredited and licensed private higher education institution, may receive funds from the Ministry for certain activities. They may also participate in calls for proposals in higher education and scientific-research announced by the Ministry or other public</p>	<p>1. Privatne institucije visokog obrazovanja su odgovorne za svoje finansiranje, i mora da dostave dokaze o njihovom finansijskom stabilnošću pre nego što budu licencirane.</p> <p>2. Jedna privatna institucija visokog obrazovanja, akreditovana i licencirana može primiti sredstva od strane Ministarstva za određene aktivnosti. Oni takođe mogu učestvovati u pozivima za podnošenje predloga u visokom obrazovanju i</p>



<p>Ministria apo ndonjë organ tjetër publik në Kosovë ose nga organizatat ndërkombëtare.</p> <p>3. Këshilli drejtues, organi ekuivalent, apo pronari i një institucioni privat të arsimit të lartë është përgjegjës para Ministrisë dhe organeve të tjera kompetente për përdorimin e duhur dhe efektiv të fondeve që i janë caktuar institucionit nga Ministria ose nga burime të tjera publike.</p>	<p>body in Kosovo or by international organisations.</p> <p>3. Steering Council, the equivalent body or owner of a private institution of higher education is responsible before the Ministry for the proper and effective use of funds that are assigned to the institution by the Ministry or by other public resources.</p>	<p>istraživanju koje je izdalo Ministarstvo ili drugi javni organ na Kosovu ili od strane međunarodnih organizacija.</p> <p>3. Upravni odbor, ekvivalentni organ ili vlasnik privatne institucije visokog obrazovanja je odgovoran pred Ministrom i drugim kompetentnim organima za pravilno i efikasno korišćenje sredstava koja su dodeljena instituciji od strane Ministarstva ili drugih javnih izvora.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 49</b> <b>Garantimi i interesave të studentëve</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 49</b> <b>Guarantee of students' interests</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 49</b> <b>Garancija studentskih interesa</b></p>
<p>1. Institucionet private duhet të garantojnë interesat e studentëve në rast të mbylljes, falimentimit ose humbjes së akreditimit ose licencës, si më poshtë:</p> <p>1.1. Prezentimi i garantimit të stabilitetit financiar për së paku një (1) vit, i lëshuar nga institucioni përkatës; shuma e pasurive të institucionit të arsimit të lartë duhet të jetë së paku e barabartë me 50% të tarifës së studimit, që paguhet nga të gjithë studentët e regjistruar në vitin përkatës akademik; natyra dhe shuma e garancisë financiare për studentët mund të shpjegohet në detaje të mëtejme dhe me një akt nënligjor të lëshuar nga</p>	<p>1. Private institutions must guarantee the students' interest in case of closure, bankruptcy or loss of accreditation or licence, as follows:</p> <p>1.1. Presentation of a guarantee of financial stability for at least one (1) year issued by the respective institution; the amount of assets of the higher education institution must be at least equal to 50% of the study fee paid by all students enrolled in the corresponding academic year; the nature and amount of the financial guarantee for students may be further explained in details and with a sub-legal act issued by the Minister;</p>	<p>1. Privatne institucije moraju garantovati interese studenata u slučaju zatvaranja, stečaja ili gubitka akreditacije ili licence kao u nastavku</p> <p>1.1. Predstavljanje garancije o finansijskoj stabilnosti za najmanje jednu (1) godinu, izdato od strane relevantne institucije; iznos sredstava institucije visokog obrazovanja mora biti najmanje jednak 50% tarife za studije koju plaćaju svi studenti koji su upisani u odgovarajuću akademsku godinu; priroda i iznos finansijske garancije za studente može se dalje objasniti detaljnije i jednim podzakonskim aktom izdatom od strane Ministra;</p>

<p>Ministri;</p> <p>1.2. Marrëveshjet me së paku dy (2) institucione të tjera të akredituara të arsimit të lartë, duke siguruar që studentët mund të transferohen në programe të ngjashme në një nga këto institucione të akredituara, në rast të mbylljes, falimentimit apo tërheqjes së akreditimit; AKA dhe ministri duhet të japin pëlqimin për marrëveshjet e arritura. Në rast të transferimit, institucioni nikoqir duhet të garantojë pranimin dhe studimin me ritme të njëjta si institucioni që është mbyllur, ka falimentuar apo është privuar nga licenca.</p> <p>2. Një institucion privat i arsimit të lartë mund të mbyllet nga Këshilli drejtues ose ndonjë organ tjetër ekuivalent, por vetëm në fund të vitit akademik, me qëllim që t'u mundësohet studentëve përfundimi i provimeve.</p> <p>3. Një institucion privat i arsimit të lartë mund të mbyllet nëse është tërhequr apo nuk renovohet akreditimi nga AKA apo nëse i është tërhequr licenca e institucionit nga Ministria.</p> <p>4. Pavarësisht nga arsyeja e mbylljes,</p>	<p>1.2. Agreements with at least two (2) other accredited institutions of higher education ensuring that students can be transferred to similar programs at one of these accredited institutions, in case of closure, bankruptcy or withdrawal of accreditation; KAA and the Minister must give consent for the reached agreements. In case of transfer, the host institution should guarantee the acceptance and study with same rates as the institution that is closed, bankrupt or deprived of license.</p> <p>2. A private higher education institution may be closed by the Steering Council or any other equivalent body, but only at the end of an academic year, in order to enable students to complete examinations.</p> <p>3. A private higher education institution of may be closed if the accreditation is withdrawn or not renewed by KAA or if the institution's license by the Ministry is withdrawn.</p> <p>4. Regardless the reason of closure, the</p>	<p>1.2. Sporazumi sa najmanje dve (2) druge akreditovane institucije visokog obrazovanja koji osiguraju da se prelazak studenata na slične programe u jednoj od ovih akreditovanih institucija, u slučaju zatvaranja, stečaja ili povlačenja akreditacije; KAA i ministar moraju dati saglasnost za postignute sporazume. U slučaju prelaska, institucija domaćin bi trebalo da garantuje prihvatanje i studije sa istim stopama kao institucija koja je zatvorena, u stečaju ili je lišena licence.</p> <p>2. Privatna institucija visokog obrazovanja može biti zatvoren od strane Upravnog odbora ili bilo kojeg ekvivalentnog tela, ali samo na kraju akademske godine, kako bi se omogućilo studentima da završe ispite.</p> <p>3. Privatna institucija visokog obrazovanja može da se zatvori ako je akreditacija od strane KAA povučena ili se ne obnavlja ili ako se povlači licenca institucije od strane ministarstva.</p> <p>4. Bez obzira na razlog zatvaranja, institucija</p>
--	---	---

<p>institucioni është i detyruar të përgatisë një raport të detajuar për Ministrinë dhe të dërgojnë pasqyrat e notave për çdo student. Dokumentet duhet të lëshohen nga institucioni dhe dorëzohen në Ministri, brenda 30 ditëve nga data e vendimit për mbyllje.</p> <p><b>KAPITULLI XIII: DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 50 Akademia e Kosovës për Siguri Publike</b></p> <p>1. Akademia e Kosovës për Siguri Publike, e themeluar me Ligjin nr. 04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 26, 25 nëntor 2011), është institucion përgjegjës për ofrimin e arsimit të lartë për të gjitha institucionet e sigurisë publike por duke mos u kufizuar vetëm në to.</p> <p>2. Dispozitat e këtij Ligji zbatohen duke u përshtatur për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, me përjashtimet e përcaktuara në Ligjin për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike.</p>	<p>institution is obliged to prepare a detailed report for the Ministry and to send the overview of grades for each student. The documents must be issued by the institution and submitted to the Ministry within 30 days from the date of the decision for closure.</p> <p><b>CHAPTER XIII: TRANSITIONAL AND FINAL PROVISIONS</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 50 Kosova Academy for Public Safety</b></p> <p>1. Kosova Academy for Public Safety, established by Law no. 04 / L-053 on Kosova Academy for Public Safety (Official Gazette of the Republic of Kosova, No. 26, 25 November 2011) is an institution responsible for providing higher education for all public safety institutions but not being limited only in them.</p> <p>2. The provisions of this Law shall apply appropriately to the Kosova Academy for Public Safety, with exceptions set out in the Law on Kosova Academy for Public Safety.</p>	<p>je dužna da pripremi detaljan izveštaj za ministarstvo i pošalje pregled ocena za svakog studenta. Dokumenti mora biti izdati od strane institucije i dostaviti ministarstvu u roku od 30 dana od dana donošenja odluke za zatvaranje.</p> <p><b>POGLAVLJE XIII: PRELAZNE I ZAVRŠNE ODREDBE</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 50 Kosovska akademija za javnu bezbednost</b></p> <p>1. Kosovska akademija za javnu bezbednost, osnovana je Zakonom br. 04/L-053 o Kosovskoj akademiji za javnu bezbednost (Službeni list Republike Kosova, br. 26, 25. novembar 2011) je institucija koja je odgovorna za pružanje visokog obrazovanja, ali ne ograničavajući se na sve institucije javne bezbednosti.</p> <p>2. Odredbe ovog Zakona shodno će se primeniti za Kosovsku akademiju za javnu bezbednost, sa izuzecima utvrđenim u Zakonu o Kosovskoj akademiji za javnu bezbednost.</p>
---	---	--

<p>3. Arsimi i lartë në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike zhvillohet në përputhje me rregullat dhe procedurat përkatëse për akreditim sipas këtij ligji.</p> <p>4. Zhvillimi i arsimit të lartë në Akademi, rregullohet me akt nënligjor të miratuar nga Qeveria pas propozimit të ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe ministrit për Punë të Brendshme.</p>	<p>3. Higher Education at the Kosova Academy for Public Safety is conducted in accordance with relevant rules and procedures for accreditation according to this Law.</p> <p>4. Development of higher education in the Academy is regulated by sub-legal act approved by the Government upon the proposal of the Minister of Education, Science and Technology and the Minister for Internal Affairs.</p>	<p>3. Visoko obrazovanje u Kosovskoj akademiji za javnu bezbednost se sprovodi u skladu sa odgovarajućim pravilima i procedurama za akreditaciju prema ovom važećem Zakonu.</p> <p>4. Razvoj visokog obrazovanja u Akademiji je regulisano podzakonskim aktom usvojenim od strane Vlade na predlog Ministarstva obrazovanja nauke i tehnologije i ministra Ministarstva unutrašnjih poslova.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 51</b> <b>Universiteti që vepron në Mitrovicën Veriore</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 51</b> <b>University that acts in Northern Mitrovica</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 51</b> <b>Univerzitet koji deluje u Severnoj Mitrovici</b></p>
<p>1. Universiteti që vepron në Mitrovicën Veriore është institucion publik autonom i arsimit të lartë i themeluar sipas Ligjit nr. 03/068 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 30, 15 qershor 2008) dhe Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28, 4 qershor 2008).</p> <p>2. Universiteti miraton statutin që paraqet organizimin dhe qeverisjen e brendshme të tij si dhe procedurat dhe ndërveprimin me autoritetet publike, në pajtim me kornizën</p>	<p>1. University that acts in Northern Mitrovica is an autonomous public higher education institution established under the Law no. 03/068 on Education in Municipalities of the Republic of Kosova (Official Gazette of the Republic of Kosova, no. 30, 15 June 2008) and Law no. 03 / L-040 on Local Self-Government (Official Gazette of the Republic of Kosova, no. 28, 4 June 2008).</p> <p>2. The University adopts a statute which presents its organization and internal governance as well as the procedures and interaction with public authorities, in</p>	<p>1. Univerzitet koji deluje u Severnoj Mitrovici je autonomna javna institucija visokog obrazovanja osnovana prema zakonu br. 03/068 o obrazovanju u opštinama Republike Kosova (Službeni list Republike Kosova, br. 30, 15. jun 2008), zakonu br. 03/L-040 o Lokalnoj samoupravi (Službeni glasnik Republike Kosova, br. 28, 4. jun 2008).</p> <p>2. Univerzitet usvaja statut koji predstavlja svoju organizaciju i unutrašnju upravu, kao i procedure i interakciju sa javnim vlastima, u skladu sa centralnim zakonodavnim okvirom</p>

<p>ligjore qendrore të Republikës së Kosovës, i cili do të shqyrtohet nga një komision i pavarur.</p> <p>3. Zhvillimi i arsimit të lartë në Universitetin në Mitrovicës Veriore rregullohet me akte nënligjore të miratuara nga Qeveria, pas propozimit të ministrit, që do të hartohet në përputhje me legjislacionin në fuqi që ndërlidhet me Universitetin dhe me këtë Ligj.</p> <p>4. Asgjë në këtë Ligj dhe në aktet nënligjore në fuqi të nxjerra sipas tij apo në dispozitat e çfarëdo ligji tjetër, nuk do të kufizoj kompetencat e zgjeruara të Komunës së Mitrovicës së Veriut.</p>	<p>accordance with central legislation framework of the Republic of Kosova, which will be reviewed by an independent commission.</p> <p>3. Development of higher education at the University of North Mitrovica is regulated by sub-legal acts approved by the Government upon the proposal of the Minister, which will be drafted in accordance with the legislation in force, which is related to the University and with this Law.</p> <p>4. Nothing in this Law and in sub-legal acts in force issued under it, or in provisions of any other law, will limit the enhanced competences of Municipality of Northern Mitrovica.</p>	<p>Republike Kosova, koji će biti razmatran od strane jedne nezavisne komisije.</p> <p>3. Razvoj visokog obrazovanja na Univerzitetu u Severnoj Mitrovici je regulisan podzakonskim aktima usvojenih od strane Vlade na predlog ministra, koji će biti izrađeni u skladu sa važećim zakonima koji se odnose na Univerzitetu i sa ovim zakonom.</p> <p>4. Ništa u ovom Zakonu i važećim podzakonskim aktima donetim na osnovu njega, ili u odredbama bilo kojeg drugog zakona, neće ograničiti proširene nadležnosti Opštine u Severnoj Mitrovici.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 52</b> <b>Aktet nënligjore</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 52</b> <b>Sub-legal acts</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 52</b> <b>Podzakonski akti</b></p>
<p>1. Qeveria dhe ministri i Arsimit, miratojnë aktet nënligjore për zbatimin e këtij Ligji, më së largu një (1) vit pas hyrjes në fuqi të tij.</p> <p>2. Institucionet e arsimit të lartë duhet të hartojnë të gjitha aktet e tyre në përputhje me dispozitat e këtij Ligji dhe legjislacionit përkatës në fuqi që nxirret në zbatim të këtij Ligji.</p>	<p>1. The Government and the Minister of Education adopts sub-legal acts for implementation of this Law, not later than one (1) year after its entry into force.</p> <p>2. Higher education institutions should draft all their acts in accordance with the provisions of this Law and the relevant legislation in force issued for implementation of this Law.</p>	<p>1. Vlada i ministar usvajaju podzakonske akte u cilju sprovođenja ovog Zakona, naj kasnije jednu(1) godinu nakon stupanje na snagu Zakona.</p> <p>2. Vlada i ministar usvajaju podzakonske akte za sprovođenje ovog Zakona, najkasnije u roku od jedne (1) godine nakon stupanja na snagu Zakona.</p>

<p style="text-align: center;"><b>Neni 53</b> <b>Dispozitat kalimtare</b></p> <p>1. Të gjitha institucionet e arsimit të lartë duhet që t'i harmonizojnë statutet dhe rregulloret e tyre me dispozitat e këtij Ligji, brenda një periudhe kohore jo më vonë se dymbëdhjetë (12) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji.</p> <p>2. Zgjedhjet e reja për organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë duhet të zhvillohen në përfundim të mandatit të autoriteteve dhe organeve ekzistuese dhe sipas përcaktimeve të këtij Ligji.</p> <p>3. Pranimi i studentëve në institucionet e arsimit të lartë për vitin vijues akademik në të gjitha programet e studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë, kryhet sipas përcaktimeve të këtij Ligji.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 53</b> <b>Transitional provisions</b></p> <p>1. All higher education institutions should harmonize their statutes and regulations with provisions of this Law within a time period no later than twelve (12) months after entry into force of this Law.</p> <p>2. New elections for the steering bodies in public higher education institutions shall be held at the end of the existing bodies and authorities mandate and in accordance with this Law.</p> <p>3. Admission of students in higher education institutions for the following academic year in all study programs provided from higher education institutions is carried out according to this Law.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 53</b> <b>Prelazne odredbe</b></p> <p>1. Sve institucije visokog obrazovanja treba da usklade svoje statute i uredbe sa odredbama ovog Zakona u roku ne kasnije od dvanaest (12) meseci od dana stupanja na snagu ovog Zakona.</p> <p>2. Novi izbori za upravne organe u javnim institucijama visokog obrazovanja biće održani krajem mandata postojećih organa i vlasti u skladu sa ovim Zakonom.</p> <p>3. Prijem studenata u institucijama visokog obrazovanja za narednu akademsku godinu u svim programima studija pružanih od strane Institucija visokog obrazovanja obavlja se u skladu sa ovim Zakonom.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 54</b> <b>Zbatimi i Ligjit për procedurën administrative</b></p> <p>Nëse me këtë Ligj nuk përcaktohet ndryshe, për procedurën e punës në institucionet e arsimit të lartë, zbatohen dispozitat e ligjit për procedurën e përgjithshme administrative.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 54</b> <b>Implementation of the Law on administrative procedure</b></p> <p>If this law does not specify otherwise, for the working procedure in institutions of higher education are applied for the provisions of the law on general administrative procedure.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 54</b> <b>Primenjvanje zakona za administrativnu proceduru</b></p> <p>Ukoliko ovim Zakonom nije drukčije precizirano, za radne procedure u institucijama visokog obrazovanja sprovodi se odredbe zakona o opštem upravnom postupku.</p>

<p style="text-align: center;"><b>Neni 55 Shfuqizimi</b></p> <p>1. Ky Ligj shfuqizon:</p> <p>1.1. Ligjin nr. 04/L-037 për arsimin e lartë (Gazeta zyrtare nr. 14, 9 shtator 2011), dhe</p> <p>1.2. Çdo dispozitë të legjislacionit që bie në kundërshtim me këtë Ligj, e që ka të bëjë me arsimin e lartë.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 55 Repeal</b></p> <p>1. This Law repeals:</p> <p>1.1. Law no. 04/L-037 on higher education (Official Gazette no. 14, 9 September 2011), and</p> <p>1.2. Any provision of legislation that is inconsistent with this Law and that deals with higher education.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 55 Stavljanje van snage</b></p> <p>1. Ovaj Zakon stavlja van snage:</p> <p>1.1. Zakon br. 04/L-037 o visokom obrazovanju (Službeni list, br. 14, 9. septembar 2011), i</p> <p>1.2. Bilo koju zakonodavnu odredbu koja je u suprotnosti sa ovim zakonom a koja se odnosi na visoko obrazovanje.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 56 Hyrja në fuqi</b></p> <p>Ky Ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.</p> <p style="text-align: right;">Kadri Veseli</p> <hr style="width: 20%; margin-left: auto; margin-right: auto;"/> <p style="text-align: center;">Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 56 Entry into force</b></p> <p>This Law enters into force fifteen (15) days after publication in the official gazette of the Republic of Kosova.</p> <p style="text-align: right;">Kadri Veseli</p> <hr style="width: 20%; margin-left: auto; margin-right: auto;"/> <p style="text-align: center;">The President of the Assembly of the Republic of Kosovo</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 56 Stupanje na snagu</b></p> <p>Ovaj Zakon stupa na snagu petnaest (15) dana od dana objavljivanja u Službeni glasnik Republike Kosovo.</p> <p style="text-align: right;">Kadri Veseli</p> <hr style="width: 20%; margin-left: auto; margin-right: auto;"/> <p style="text-align: center;">Predsednik Skupštine Republike Kosovo</p>